

AGIM LEKA

MENDOJ
si
EUROPIAN

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2025

Mirënjohje të thellë
ndaj z. Gjergj Luca dhe kompanisë së tij ROZAFa,
që bënë të mundur botimin e këtij libri filozofik.
Ky kontribut i tij është një dëshmi e vlerës që i jep mendimit
të lirë, reflektimit dhe përhapjes së dijes në shoqërinë tonë.

AUTORI

Botuese: Irena Toçi

Redaktor: Prof. as. Albert Riska

Korrektore letrare: Majlinda Bami

ISBN 9789928960115

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij libri nuk mund të riprodhohet pa leje paraprake.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja" nr. 71, Tiranë 1023.

Kutia Postare 1420

E-mail: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al/>

*Formimi, pjekuria dhe zhvillimi i mendimit racional kritik
perëndimor, arsimimi dhe profesionalizimi shkencor si produkte
të integritit të filozofisë, shkencës dhe fesë, në procesin e
edukimit në shkollë dhe gjatë jetës përmes komunikimit e
metodës sokratike [Socratic Method]*

Katër pjesë dhe dymbëdhjetë rekomandime në shqip

The fifth part

*The crisis of thought in the context of the post-communist
transition*

*Integration of religion with laicity and secular education
A hypothesis for the school, not only*

*Për Ergi, Jacqueline,
Alessandro, Ralf dhe Tanja*

Mesazh

Tranzicioni i shumëfishtë, si kalim nga shoqëria totalitare në shoqëri demokratike, ka substancë kalimin nga mendimi ideologjik në mendim filozofik, kritik dhe reflektiv.

Kjo do të thotë se e ardhmja jonë dhe e brezave pasardhës ndërtohet vetëm me njerëz mendjehapur, komunitete qytetare dhe shoqëri demokratike, të integruara, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, duke shmangur paragjykimet ideologjike në përgjithësi dhe paragjykimet fetare në veçanti, konfliktet dhe radikalizmin e dhunshëm.

Në kontekstin shqiptar tranzicioni i shumëfishtë posttotalitar ka substancë transformimin e ideve të natyrshme europiane të shqiptarëve në mendim european bashkëkohor.

Integrimi european i shqiptarëve është së pari realizim intelektual si tranzicion mendor. Procesi është i kryer kur mendimi dhe vlerat e shqiptarëve janë në standardin europoperëndimor.

Për mësuesit dhe prindërit

Para së gjithash edukoni fëmijët të ndershëm, të thonë vetëm të vërtetën, të veprojnë mirë dhe të krijojnë të bukurën në jetë. Vetëm kështu do të vdisni të qetë, sepse ata/o do të ruajnë dhe shtojnë pasurinë që do të mund t'u keni lënë trashëgim. Në qoftë se pasardhësve nuk u keni trashëguar vlerat e mësipërme, ata/o edhe varrin do t'ua shkatërrojnë.

Detyra juaj nuk është t'u mësoni nxënësve (fëmijëve) të vërtetën. Krijoni për ta situata dhe kushte që të nxënë.

Udhëhiqni ata/o që të nxënë rrugën e zbulimit të vërtetës. E vërteta nuk është ajo që dini, besoni dhe thoni ju.

E vërteta është brenda nxënësit (fëmijës) dhe ai e beson atë në qoftë se e zbulon vetë.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Parathënie	15
Konteksti i përdorimit të fjalës “mendoj”	16
Metodologjia dhe metoda e kërkimit	21
Falënderim	23
Ftesë për lexim	25

PJESA E PARË

TRANZICIONI NGA MENDIMI SINKRETIK TE BESIMI FETAR DHE MENDIMI RACIONAL

I. 1. Mendimi parafilezofik	29
I. 2. Miti filezofik	37
I. 3. Diç filezofike	40
I. 4. Mendimi filezofik dhe mendimi shkencor	43
<i>I. 4. A. Mendimi filezofik është integral</i>	<i>44</i>
I. 5. Edukimi i vlerave njerëzore	53
I. 6. Edukimi fetar	55
I. 7. Degët tradicionale të filezofisë	57
I. 8. Historia e filezofisë, themeli i formimit filezofik	58

PJESA E DYTË

FORMIMI I MENDIMIT FETAR E FILOZOFIK GJATË QYTETËRIMEVE TË LASHTA

II.1. Formimi i mendimit fetar e filezofik gjatë qytetërimeve të lashta	69
<i>II. 1. 1. Tradita mesopotamike në edukim. “Lexoj, pra mendoj”</i>	<i>71</i>
<i>II. 1. 2. Edukimi në Egjiptin e Lashtë bazuar në mite dhe në mendimin racional</i>	<i>75</i>
<i>II. 1. 3. Pikëpamjet filezofike të qytetërimit Hindu (India e lashtë)</i>	<i>78</i>

II. 1. 4. Edukim përmes bindjeve dhe analizës së fakteve. Shkolla filozofike Mimamsa.....	79
II. 2. Filozofia dhe feja etike në Kinën e lashtë	83
II. 2. 1. Rruga e mesme e edukimit budist	83
II. 2. 2. Konfucizmi. Edukimi në kontekstin e familjes dhe të komunitetit	85
II. 2. 3. Taoizmi. “Mësuesi i vjetër kinez”	89
II. 2. 4. Daoizmi kinez.....	89
II. 2. 5. Sofistët kinezë	91
II. 2. 6. Fjalorth i shkurtër dhe disa parime të filozofisë së lashtë kineze	91
II. 2. 7. Formimi i njeriut bazuar në filozofitë lindore.....	94

PJESA E TRETË

ZHVILLIMI I MENDIMIT FILOZOFIK NGA ANTIKITETI DERI SOT

III. 1. Antikiteti - koha e formimit të filozofisë. Stërgjyshërit e filozofisë antike perëndimore	101
III. 1. 1. Greqia antike, atdheu i filozofisë dhe i logjikës	105
III. 1. 2. Parasokratikët, stërgjyshërit e filozofisë antike perëndimore	107
III. 2. Qytetërimi athinas dhe mendimi filozofik i atomistëve.....	109
III. 2. 1. Lëvizja Sofiste. Dija relative dhe subjektive.....	112
III. 3. Sokrati, Platoni e Aristoteli - tre kulmet e filozofisë antike perëndimore.....	114
III. 4. Edukimi funksionalist bazuar në filozofinë e Platonit	121
III. 4. 1. Tri pjesët e filozofisë së Platonit	123
III. 4. 2. Teoria e njohjes platoniane	124
III. 4. 3. Platoni kundër sofistëve në fushën e moralit	128
III. 4. 4. Modeli platonian i shoqërisë ideale është utopik	130
III. 4. 5. Kozmologjia e Platonit	131
III. 5. Filozofia aristoteliane baza e edukimit moral	134
III. 5. 1. Filozofia sistem gjithëpërfshirës i dijes	135
III. 5. 2. Struktura e sistemit aristotelian	136
III. 5. 3. Logjika e Aristotelit	139
III. 5. 4. Etika e Aristotelit	139
III. 5. 5. Aristoteli për natyrën	141
III. 5. 6. Filozofia e artit.....	142
III. 5. 7. Qeveria e mirë udhëhiqet nga e mira e përbashkët	143
III. 5. 8. Projeksioni i koncepteve të Aristotelit në kontekstin e epokës globale....	145

III. 5. 9. Rikthimi te Aristoteli si rimendim përmes refleksionit	148
III. 5. 10. Nga “sophia” te “philosophia”. Nga ideja te koncepti logjik, substanca dhe vlerat	148
III. 5. 11. Qenia globale “fluide”. Nga “substanca universale” te “metafora e substancës”	153
III. 5. 12. Qasja aristoteliane kundrejt universalizmit kantian në kontekstin e integritetit evropian	154
III. 5. 13. Projektioni i lëvizjes aristoteliane në realitetin integruar	155
III. 5. 14. Tranzicioni përmes lëvizjes integruar	160
III. 5. 15. Tranzicioni modern postdiktatorial	162
Fjalorth i disa termave filozofikë dhe politikë të Aristotelit	164
III. 6. Dija dhe jeta praktike në epokën helenistike-romake	168
III. 6. 1. Kulmi i filozofisë helenistike	170
III. 6. 2. Shkollat e filozofisë stoike paraprijnë krishterimin	172
III. 6. 3. Epikurianizmi dhe hedonizmi	181
III. 6. 4. Skepticizmi akademik	184
III. 6. 5. Sintesa e filozofisë greke me shkrimet hebraike. Filoni [Philo] i Aleksandrisë	185
III. 6. 6. Tranzicioni nga paganizmi dhe nga judaizmi në kristianizëm	186
III. 6. 7. Manihizmi. Gnosticizmi dhe “Ungjilli i Vërtetë”	188
III. 7. Mendimi filozofik në antikitetin e vonë	192
III. 7. 1. Plotini themelues i neoplatonizmit	193
III. 7. 2. Tranzicioni i mendimit evropian në vitet 300-600. Dy qytetërimet dhe shkollat filozofike	194
III. 7. 3. Feja kristiane shpallet fe zyrtare	196
III. 7. 4. Arianizmi vazhdon	200
III. 7. 5. Mendimi filozofik i doktorëve të kishës perëndimore	201
III. 7. 6. Aristotelizmi mesjetar dhe platonizmi i krishterë perëndimor	203
III. 7. 7. Lëvizja e murgjve dhe Grigori i Madh. Asketizmi (eremitët). Benediktianët.	208
III. 8. Filozofia në kontekstin e Mesjetës	213
III. 8. 1. Mesjeta nga shek. V deri në shek. XV	213
III. 8. 2. Filozofia në epokën e errësirës	214
III. 8. 3. Skolastika mesjetare	216
III. 8. 4. Universalja dhe nominalja. Beso duke kërkuar të kuptosh	218
III. 8. 5. Th. Akuini bashkon filozofinë me teologjinë duke “krishteruar” Aristotelin	221
III. 8. 6. Tomizmi	226
III. 8. 7. Filozofia arabe në mesjetë	228

III. 8. 8. <i>Avicena ose Ibn Sina</i>	231
III. 8. 9. <i>Averroes ose Ibn Rushdi</i>	232
III. 8.10. <i>Filozofi hebre Moshe Maimonide, pararendës i racionalizmit</i>	233
III. 8.11. <i>Rilindja franceze</i>	234
III. 9. Filozofia racionaliste europiane	237
III. 9. 1. <i>Babai i filozofisë moderne dhe i frymës së re shkencore</i>	243
III. 9. 2. <i>Filozofia empirike europiane</i>	253
III. 9. 3. <i>Empirizmi anglez</i>	255
III. 9. 4. <i>Nga racionalizmi klasik deduktiv tek empirizmi eksperimental dhe iluminizmi</i>	259
III. 9. 5. <i>Spinozmi</i>	261
III. 9. 6. <i>Komunikimi filozofik përmes diskursit</i>	264
III. 9. 7. <i>David Hume</i>	265
III. 9. 8. <i>Filozofia analitike politike moderne</i>	270
III. 9. 9. <i>Filozofia iluministe dhe qytetërimi</i>	279
III. 9. 10. <i>Tranzicioni nga arsyeja tek emocioni</i>	283
III. 9. 11. <i>Lindja e filozofisë klasike gjermane. Katër nivelet e saj</i>	284
III. 9. 12. <i>Kantizmi</i>	286
III. 9. 13. <i>Postkantizmi</i>	308
Fjalorth i termave të filozofisë kantiane	309
III. 9. 14. <i>Filozofia e “edukimit të hapur”. Pedagogjia pragmatiste e Xhon Djujt</i>	312
III. 9. 15. <i>Mendimi filozofik në shekullin XX</i>	315
III. 9. 16. <i>Mendimi filozofik shqiptar</i>	319
III. 9. 17. <i>Filozofia në sistemin shkollor shqiptar</i>	323
III. 9. 18. <i>Tranzicioni i edukimit shkollor, nga sistemi ideologjik në sistemin e vlerave</i>	326

PJESA E KATËRT

INTEGRIMI I FESË ME EDUKIMIN NË SHKOLLË

IV. 1. <i>Rimendimi i laicitetit dhe i sekularitetit. Nga Aristoteli te Jürgen Habermas</i>	337
IV. 2. <i>Integrimi i shkencës, fesë dhe filozofisë në procesin e edukimit laik</i>	340
IV. 3. <i>Konteksti historik i feve dhe besimeve në Shqipëri</i>	343
IV. 3. 1. <i>Krishterimi</i>	343
IV. 3. 2. <i>Kisha Autoqefale Shqiptare</i>	344
IV. 3. 3. <i>Islamizmi</i>	344
IV. 3. 4. <i>Bektashizmi</i>	345
IV. 3. 5. <i>Kisha Ungjillore Protestante</i>	345

IV. 4. Besimet fetare në periudhën 1944-1990.....	346
IV. 4. 1. <i>Ateizmi shtetëror.....</i>	346
IV. 4. 2. <i>Besimet fetare pas viteve '90 të shek. XX.....</i>	346
IV. 5. Konteksti kulturor shqiptar i besimit fetar. Shtrirja e besimit fetar.....	346
IV. 5. 1. <i>Identiteti shqiptar dhe feja.....</i>	347
IV. 5. 2. <i>Respekti përmes pranimit të tjetrit</i>	348
IV. 6. Situata aktuale në Shqipëri	349
IV. 7. Përvoja europiane.....	350
IV. 8. Tendenca e zhvillimit	351
IV. 9. Ligjshmëria	353
IV. 10. Rrugët e integritetit të fesë në kurrikulën e shkollës publike laike	354
IV. 11. Ora e mësimi të njohurive rreth fesë dhe besimeve.....	355
IV. 11. 1. <i>Mësuesi/ja zhvillon njohuritë mbi fenë.....</i>	356
IV. 11. 2. <i>Mësuesi/ja zotëron “didaktikën e zhvendosjes”</i>	356
IV. 11. 3. <i>Besimi/mosbesimi fetar i mësuesit/es</i>	357
IV. 11. 4. <i>Tekst shkollor për fushën e nxënies rreth fesë?!</i>	358
IV. 11. 5. <i>Librat fetarë dhe biblioteka e shkollës</i>	359
IV. 12. Pjesëmarrja në veprimtari fetare	359
IV. 13. A mundet nxënësi të shprehë besimin fetar në shkollë?	360
IV. 14. Falja e nxënësve dhe këndet e faljes	361
IV. 15. Veshja fetare në shkollën publike	361
IV. 16. Vizitat në institucionet fetare dhe në vendet e shenjta.....	362
IV. 17. Të ftuarit në veprimtaritë shkollore.....	363
IV. 18. Burimi i informacionit mbi fenë dhe besimet.....	363
IV. 19. Dijsa dhe feja nuk vrasin	363
IV. 20. Dialogu mes fesë dhe shkencës.....	364
IV. 21. Hipoteza e Big Bang mbi origjinën e sistemit diellor është shkencore.....	366
DYMBËDHJETË REKOMANDIME	369
Rekomandimi i parë.....	369
Rekomandimi i dytë	370
Rekomandimi i tretë.....	370
Rekomandimi i katërt.....	371
Rekomandimi i pestë.....	371

Rekomandimi i gjashtë.....	372
Rekomandimi i shtatë.....	372
Rekomandimi i tetë	373
Rekomandimi i nëntë	374
Rekomandimi i dhjetë	375
Rekomandimi i njëmbëdhjetë.....	375
Rekomandimi i dymbëdhjetë	376
 SHTOJCË	 377
PROVONI VETEN.....	378
TESTI NJË	378
TESTI DY	381
TESTI TRE	384
TESTI KATËR.....	387
 THE FIFTH PART	
The crisis of thought in the context of the post-communist transition.....	389
Integration of religion with laicity and secular education. A hypothesis for the school, not only.....	405
 FJALORTH I TERMAVE.....	 445
BURIME INFORMACIONI	469

PARATHËNIE

Përmbajtja e librit *MENDOJ SI EUROPIAN* është fokusuar te ndërtimi i mendimit përmes edukimit, duke integruar filozofinë, shkencën dhe fenë në institucionet: familja, komunitetit qytetar, shkolla, shteti dhe institucionet fetare.

Titulli i librit është produkt i kërimit të thellë e të gjatë filozofik për mendimin dhe i mbledhjes së të dhënave gjatë eksperiencës në procesin mësimor edukativ parauniversitar dhe në shkollën e lartë.

Edukimi është proces i gjerë. Është përvetësimi i njohurive, zhvillimi i aftësive, ndërtimi i vlerave, besimeve dhe i zakoneve. Ai përfshin procesin mësimor.

Edukimi, në kontekstin publik, zhvillohet nën drejtimin e edukatorëve/mësuesve dhe ka në qendër nxënësin. Natyrisht, institucionet e edukimit mund të jenë publike ose jopublike.

Shkencat e edukimit, filozofia dhe njohuritë mbi fenë janë tri shtylla mbi të cilat ndërtohet godina e formimit shkencor të njeriut përmes shkollimit laik e sekular.

Natyrisht, edukimi fillon në familje dhe vijon në çerdhe, vazhdon në sistemin parashkollor, në shkollën fillore, në shkollën e mesme të ulët (8-9-vjeçare) dhe të mesme të lartë (gjimnazi dhe shkolla profesionale/lice), në institucionet e arsimit të lartë (IAL) (universiteti, akademia, instituti, koleji), dhe vazhdon gjatë gjithë jetë së njeriut.

Duke qenë shumë i gjerë, studimi ynë është fokusuar tek edukimi i mendimit dhe ndërtimi i vlerave themelore njerëzore.

Modeli i shoqërisë së qëndrueshme projektohet nga mendje të zhvilluara, të bazuara mbi themele të vërtetash dhe që zhvillohen e pasurohen gjithë jetën

në mënyrë të ekuilibruar, duke tentuar drejt një raporti sa më të saktë mes racionales dhe jo racionales, i cili është konsideruar si “raporti i artë”.

Më shumë se çdo epokë e historisë, epoka jonë globale kërkon njerëz me mendje të hapur, shoqëri të qëndrueshme, shmangie të paragjytimeve fetare, të konflikteve dhe të radikalizmit.

Prandaj fokusi ynë, në vijim, është mendimi. Si ndërtohet mendimi i njeriut gjatë procesit të shkollimit dhe pas tij.

Konteksti i përdorimit të fjalës “mendoj”

Në gjuhën shqipe fjala “mendim” ka shumë kuptime. Në libër unë e përdor termin në kuptimin e gjykitimit, arsyetimit. Po kështu edhe folja “mendoj” ka kuptimin e foljes “gjykoj”, “arsyetoj”. Kam mendim të caktuar për diçka a për dikë, di ta vlerësoj si të tillë (mendim aksiologjik ose vlerësues). Kam qëllim të bëj ose për të bërë. E përfytyroj diçka në një mënyrë të caktuar, e gjykoj, e quaj; arsyetoj.

Fjala shqipe “mendoj”, në gjuhën latine ka përgjegjëse “*cogito*” e cila është me rrënjë për “*cogitatio*” dhe në shqip do të thotë “mendim” (emër). Nisur nga kjo, unë e njësoj përmbajtjen e fjalës “mendoj” me fjalën “kuptoj”.

Fjalët “mendim”, “mendoj”, “të menduarit”, janë përdorur në kontekstin e njëlllojtë si edhe fjala “racionalitet”: “Unë mendoj” ose “unë jam racional”.

Ky konteksti është “skenari” ku zhvillohet arsyetimi ynë për mendimin në përgjithësi dhe për mendimin filozofik në veçanti.

Në këtë skenar njeriu është qenia e vetme e aftë të përdorë arsyen (të logjikojë) ose të reflektojë, pra të mendojë. Ai është qenie që është bërë (i lindur) me mendje dhe, gjatë gjithë jetës është i aftë të përdorë mendimin.

“Arti i të menduarit përfshin procesin e vënies në lëvizje të fakulteteve dhe modeleve të arsyetimit (mendimi i arsyeshëm), duke bërë deduksione me qëllim që të merren vendimet e duhura mbi të cilat ndërtohet gjithë veprimtaria” (Power Vogu, 2010).

Në kontekstin e procesit të mendimit janë vendosur lidhjet e termave “lëvizje” me “qenie”, “mendim” me “tranzicion” (lëvizje tranzitive).

Respektimi i kësaj lidhjeje objektive dialektike është një nga premisat bazë për të gjetur metodat e duhura të zhvillimit (ndërtimit) të mendimit. Pra, i është dhënë përgjigje pyetjes: “Si mund të ndërtojë njeriu mendimin?”

MENDOJ SI EUROPIAN

Ky udhëtim filozofik ka shmangur që në nisje premisën ideologjike, e cila ka në substancë pyetjen “Çfarë duhet të mendojë njeriu?”.

Të mendosh filozofikisht do të thotë të kuptosh botën në mënyrë filozofike. Filozofia është një nga instrumentet e njohjes njerëzore. Ajo nuk është një dije për të zbukuruar njeriun.

Në kontekstin historik (*kohor*), mendimi filozofik ose të kuptuarit filozofik i botës vjen, në mënyrë të natyrshme, pas të menduarit mitologjik ose foshnjor (*fëminor*) dhe pas të menduarit fetar.

Mendimi filozofik, ndonëse zhvillohet në kohë pas mendimit mitologjik, nuk është vazhdimësi. Prandaj mitologjia konsiderohet si parafilezofi.

Libri përfshin tri tematika të gjera dhe disa teste për t’u ushtruar e provuar veten, si edhe një fjalorth të shkurtër. Në mbyllje janë vendosur dymbëdhjetë rekomandime, të cilat janë produkt i kërkimit në fushën e edukimit dhe shpresoj të jenë të dobishme për një nivel të ri në këtë drejtim.

Pjesa e parë e librit përfshin tematikën e mendimit mitologjik (mendimi sendor) dhe raportin e miteve me besimin fetar dhe me mendimin racional.

Në pjesën e dytë të librit përfshihet tematika e mendimit filozofik duke filluar nga antikiteti deri në kohën tonë.

Në pjesën e tretë përfshihet tematika për integrimin e fesë me edukimin.

Fjala “filozofi” ka kuptimin e filozofisë perëndimore, e cila u themelua në Greqinë antike dhe u përhap në Europë, Angli dhe Amerikë. Pjesë të korpusit filozofik janë edhe idetë e hinduizmit, taoizmit, daoizmit, konfucizmit dhe budizmit. Nuk janë anashkaluar edhe idetë filozofike të Azisë dhe të Afrikës.

Të menduarit filozofik është procesi i njohjes dhe i të kuptuarit filozofik të botës nga njeriu. Duke menduar në mënyrë filozofike ne kuptojmë botën në mënyrë filozofike.

Mendimi filozofik fillon nga ideja ose nga koncepti dhe jo nga sendi.

Njohja filozofike realizohet përmes koncepteve të mirëfillta filozofike (konceptet e kulluara ose idetë filozofike), përmes përvojës ose eksperiencës së jetës së njeriut, si dhe përmes intuitës. Mendimi filozofik ndërtohet edhe përmes leximeve të librave filozofikë, përmes udhëtimeve dhe njohjes së jetës (kulturës) njerëzore, edhe përmes veprimtarive të tjera që pasurojnë jetën tonë të përditshme.

Sidoqoftë, pa lexim sistematik të librave nuk mund të kesh dhe nuk mund të ndërtoesh një mendim të mirë filozofik.

Njeriu kur mendon filozofikisht ka arritur nivelin më të lartë të vetëdijes. Kjo do të thotë se njohja filozofikë e botës është jo vetëm përvetësim intelektual, por edhe përvetësim shpirtëror, moral, estetik. Ajo është proces i integruar shumëdimensional.

Të menduarit filozofik realizohet kur njeriu arrin në moshë të pjekur. Fëmija nuk mund të mendojë në mënyrë filozofike.

Faza e adoleshencës është koha e formimit bazë të njeriut. Kjo është edhe koha e shkollimit të tij në sistemin fillor dhe të ulët të edukimit.

Në shkollën e mesme nxënësi futet në fazën e pjekurisë. Pikërisht, në këtë nivel, fillon të ndërtohet të menduarit filozofik.

Baza e të menduarit filozofik është abstragimi përmes përgjithësimit. Kjo do të thotë se të menduarit filozofik fillon me idetë, konceptet.

Filozofia është ndërgjegjësimit për realitetin dhe shoqërinë ku jetojmë. Të mendosh filozofikisht është të japësh përgjigje pyetjeve të vështira për të kuptuarit e jetës.

Filozofia i lejon dhe i mundëson njeriut të arrijë paqen e mendjes. Megjithëse filozofitë mund të ndryshojnë nga personi në person, secili përfiton njëlloj.

Filozofia mund të ndihmojë në trajtimin e pyetjeve të ngjashme që bëjnë edhe fetë e besimet e ndryshme. Këto pyetje mund të përfshijnë, ndër të tjera, moralin, kuptimin e jetës dhe vdekjes, si dhe kompleksitetin e universit.

Një tematikë e gjerë përfshin modelin filozofik të mendimit antik grek. Greqia antike është konsideruar si atdheu i filozofisë. Mendimi filozofik antik grek me racionalizmin, e drejta romake dhe besimi fetar janë tri shtyllat e qytetërimit europian.

Qytetarët europianë si anëtarë të familjes europiane e kanë ndërtuar identitetin e qenies së tyre mbi këto shtylla.

Mendimi filozofik fillon në shek. VI-V p.l.k. në Greqi, Kinë dhe Indi. Ne ende nuk kemi argumente se pse filozofët e kësaj kohe dhe të këtyre vendeve janë të ndryshëm mes tyre dhe as se cilat kanë qenë lidhjet e komunikimi mes tyre.

Gjatë trajtimit të tematikës së historisë së mendimit filozofik, për ta bërë dijen filozofike sa më të kuptueshme, është përdorur terminologji që tregon lidhjen e saj me jetën e zakonshme të njeriut, me familjen dhe trashëgiminë kulturore.

MENDOJ SI EUROPIAN

I referohem për këtë vështrim filozofit K. Popper (1902-1994). Ai i quan filozofët parasokratikë (shtatë të urtët) të Greqisë antike “*stërgjyshër të filozofisë*”.

Ndërkohë janë të njohur në historinë e filozofisë edhe filozofët e mëdhenj, etër të kishës perëndimore dhe lindore (doktorët e kishës).

Duke vazhduar këtë model argumentimi edhe Platoni dhe Aristotel mund të quhen etërit e filozofisë antike, ashtu si Dekarti është babai i filozofisë moderne dhe Immanuel Kanti është babai i filozofisë së mendimit kritik modern.

Njohja e feve është pjesë integrale e njohurive të historisë së njerëzimit dhe qytetërimeve.

Ky proces ⁽¹⁾ është krejtësisht i dallueshëm nga besimi në një fe specifike dhe respektimi i saj. Edhe vendet ku një fe mbizotëron qartë, duhet të mësojnë rreth origjinës së të gjitha feve, në vend që të favorizojnë një të vetme ose të inkurajojnë proselitizmin (konvertimin).

Në rekomandimin e Këshillit të Europës mbi religjionin dhe demokracinë shkruhet: “Ekziston një aspekt fetar për shumë nga problemet me të cilat ballafaqohet shoqëria bashkëkohore, siç janë: lëvizjet e patolerueshme fundamentaliste dhe aktet terroriste, racizmi, ksenofobia dhe konfliktet etnike”.

Në rekomandim konstatohet se njohuritë për fetë po mungojnë gjithnjë e më shumë në mjedisin familjar. E njëjta gjendje është edhe në Shqipëri, ku në shumicën e të rinjve ka boshllëqe të ndjeshme në këtë fushë të edukimit.

Në sistemin demokratik “politika dhe feja duhet të mbahen të ndara”. Megjithatë, demokracia dhe feja nuk duhet të jenë të pakomunikueshme. Ato duhet të jenë partnerë të vlefshëm në procesin e edukimit dhe të formimit të mendimit racional.

Duke trajtuar problemet shoqërore, autoritetet publike mund të eliminojnë shumë nga situatat që mund të çojnë në ekstremizëm fetar. Të njëjtën gjë duhet të bëjnë edhe autoritetet fetare.

Shkolla është një komponent i rëndësishëm i edukimit, i formimit të një fryme kritike në qytetarët e ardhshëm dhe të dialogut ndërkulturor.

Nxënësit, duke nxënë për historinë dhe filozofinë e feve kryesore me përmbajtje e objektivitet dhe duke respektuar vlerat e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, do të luftojnë në mënyrë efektive fanatizmin. Kuptimi i historisë së konflikteve politike në emër të fesë është thelbësor.

Në kohën tonë media sociale po zë vend të madh në procesin e edukimit të rinisë, ndërkohë që nuk siguron kontroll të mjaftueshëm të informacionit.

Përdoruesit, sidomos nxënësit e shkollës, lexojnë e shikojnë në faqe interneti informacion të papërshtatshëm dhe të paligjshëm, përjetojnë situata që ndikojnë negativisht në procesin formimit dhe edukimit mendor të tyre.

Nxënësit, në familjet dhe komunitetet e tyre, janë në kontakt të vazhdueshëm me faktet fetare dhe i përjetojnë ato mendërisht dhe shpirtërisht që në fëmijëri.

Festat e ceremonitë e ndryshme, ritet e zakonet në familje dhe përtej saj, librat, filmat e plot vepra të tjera të kulturës e të artit, media elektronike, sidomos portalet e ndryshme etj. janë disa nga stacionet e komunikimit të pavarur të nxënësve me realitete dhe fakte fetare.

Shkolla, si institucioni i vetëm profesionist i edukimit në shoqërinë demokratike, nuk mund të qëndrojë jashtë këtij zhvillimi objektiv.

Ajo nuk mund të rrënjosë dhe as nuk mund të ndalojë fenë.

Kërkesa që njohuritë mbi fenë të konsiderohen pjesë organike e edukimit, bazohet në përmbajtjen e kurrikulës së shkollës sonë.

Nxënia e njohurive rreth fesë nuk është edukim fetar. Ajo është pjesë organike e arsimimit dhe edukimit laik në shkollë.

Besimi në një fe është i ndryshëm nga vëzhgimi, nga analiza kritike e faktit fetar dhe nga racionalizmi. Përmbajtja e këtyre njohurive empirike bazohet në fakte fetare, të cilat janë të pranishme në jetën e përditshme.

Metoda e zhvillimit të procesit mësimor edukativ për tematikën fetare është metoda shkencore e bazuar në filozofinë dhe metodologjinë e shkencave të edukimit.

Krahasuar me mjediset e tjera, shkolla publike (klasa) është hapësira më e sigurt për informimin e nxënësit rreth fesë, veçanërisht krahasuar me internetin: feisbuk [facebook], tuitar [twitter], skajp [skype], uatsap [whatsapp], snapçat [snapchat] etj.

Procesi mësimor-edukativ zhvillohet nga mësuesit dhe jo nga klerikët. Mësuesi është edukatori më profesional, më i sigurt, më i përgjegjshëm dhe më i besuar për nxënien e njohurive mbi fenë dhe besimet.

Mësuesi ndërton situatat mësimore dhe drejton sistemin e teknikave për hetimin e fakteve dhe të dukurive fetare, në mënyrë që nxënësit të ndërtojnë njohuri të reja. Bashkë me nxënësit, ai/jo korrigjon ose i integron njohuritë

e reja me ato të mëparshme dhe nxënësit ndërtojnë dhe pasurojnë vlerat personale dhe shoqërore.

Në rastin shqiptar, baza e ndryshimit është tradita historike origjinale e bashkëjetesës fetare. Gjithashtu, janë specifikat e shoqërisë shqiptare në të kaluarën dhe në ditët tona, veçoritë krahinore, si dhe përvoja e sistemeve perëndimore shoqërore dhe arsimore të suksesshme.

Metodologjia dhe metoda e kërkimit

Studimi që po paraqesim në libër është bazuar në dy teori bazë që janë:

E para

Shoqëria europiane dhe e ardhmja e saj janë ndërtuar mbi tre themele të përhershme dhe të sigurta. Ato janë **njohuritë** [knowledge], **mençuria** ose urtësia [wisdom] (filozofia) dhe **vlerat** [values].

E dyta

Në shoqërinë perëndimore euroatlantike njerëzit janë prirur dhe priren ta mendojnë zhvillimin e shoqërisë sipas një vije të drejtë.

Historia e saj fillon nga foshnjëria (primitivizmi) dhe pas saj vijnë periudhat: antikiteti, mesjeta, kapitalizmi modern, post modernizmi dhe globalizimi.

Ndërkohë, kuptimi filozofik i zhvillimit të shoqërisë është zhvillimi ciklik. Edhe lëvizja e mendimit është tranzitive dhe mund të shënjohej me vijë të lakuar [elipsoide].

Baza teorike filozofike e kërkimit është mendimi kritik dhe reflektiv. Më në detaje në metodologji janë teoritë, filozofët, shkollat filozofike, apo stacionet teorike e filozofike, mbi të cilët jam ndalur dhe kam ndërtuar mendimin tim.

Jam bazuar në tregues sasiore dhe cilësorë dhe kam lehtësuar kuptimin e problemit që shqyrtoj pa u futur në labirinte teorike.

Është metodologji që bazohet në *“fleksibilitetin metodologjik dhe përshtatshmërinë”* (Patton 1989, p.181). Baza e metodës është përafrimi dhe krahasimi [approach method]. Do të thotë se nuk ndjek rrugën klasike të induksion-deduksionit, as edhe ndarjen e sasisë me cilësinë.

Situata e nisjes janë të dhënat e gjetura në terren dhe, prej andej, bëj përfundime, jo thjesht sipas induksionit logjik, por kapërcej në refleksion. Për pasojë gjykimet janë jo analitike, por gjykime vlerësuese e reflektive.

Edhe faktin që rekomandimet më rezultuan në përfundim të punimit, e konsideroj si argument i besueshmërisë së metodës së zgjedhur.

Metoda e kërkimit është bazuar te “*metoda e dopio hinkës*”. Ajo ka pamjen e dy hinkave që komunikojnë dhe janë të lidhura me një kanal të përbashkët.

Mjedisi i hartës studimore kërkimore është hapësira e triadës “*unë + mendimi kritik + mendimi reflektiv*”. Hapësira është mbushur me elementët kërkimorë me të cilët kam bërë rikonceptimin e disa kategorive, si: vlerat njerëzore, laiciteti dhe sekulariteti në arsimim e edukim, integrimi dhe identiteti, mendimi, lëvizja dhe qenia.

FALËNDERIM

Nxitja për tematikën më lindi nga vajza ime, Nertila, kur filloi studimet e larta. Bashkëbisedimi me studentët e shndërroi atë në motiv, vetëdije dhe detyrim për të shkruar librin.

Në çdo auditor rinor, sa herë që pyes “Çfarë kuptoni me termin të menduar filozofik?”, “a ka lidhje feja me filozofinë e shkencën?”, në shumicën e rasteve kam marrë përgjigje të cekët dhe naive. Në raste të tjera, kam marrë përgjigje të gabuar.

Më tej, nga biseda me mësuesit e sistemit shkollor parauniversitar, kam konstatuar se ata/o nuk kanë qartësi për termat “*besim*” dhe “argumentim” apo për “metodën sokratike” në nxënie. Gjithashtu nuk e kanë të qartë lidhjen e dijeve me vlerat njerëzore. Ashtu siç edhe nuk kanë shpesh të qartë edhe marrëdhënien mes të menduarit kritik, vlerave dhe besimit.

Për sa më sipër, ndihem i detyruar t’i falënderoj studentët e mi dhe mësuesit (ish-studentë) për bashkëbisedimet dhe kontributin e përbashkët drejt të vërtetës konsensuale në fushën e edukimit.

Arsyeja e dytë lidhet me diskutime të zhvilluara me mjaft kolegë të universiteteve për lidhjen e fesë me edukimin, si dhe nga disa referime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Me këtë rast mendova se vetëm falënderimi me përulësi për to, do të ishte i pakët. Do t’ia vlente që idetë e mia të plotësuara dhe ndoshta të korrigjuara edhe nga sugjerimet e këtyre intelektualëve t’i paraqisja të plota në këtë libër.

Besoj se me shkrimin e librit do të kem kontribuar sado pak në fushën e edukimit, duke vënë një gur në ndërtesën e godinës së bukur të formimit shkencor dhe filozofik.

AGIM LEKA

Libri që po i paraqes lexuesit nuk do të kishte këtë nivel në qoftë se nuk do të ishte kontributi i Prof. As. Albert Riska për redaktimin gjuhësor. Detyrimi për falënderim ndaj Albertit rritet sepse ai ka qenë student i talentuar i imi dhe sot koleg po kaq i aftë dhe i mirë.

Gjithashtu, profesionalizmi i Majlinda Bamit për korrektimin gjuhësor i ka sjellë botimit të librit një vlerë më shumë për lexuesin.

FTESË PËR LEXIM

Ky libër është **për çdo njeri** që e vlerëson mendimin racional dhe kupton nevojën e ushqimit cilësor të mendjes së tij.

Libri u shërben **nxënësve dhe studentëve që të ndërtojnë kompetencën e të menduarit shkencor dhe filozofik.**

Çdo mësues/e, çdo prind dhe çdo person që bën detyrën e edukatorit, duhet të nxërë që të mendojë filozofikisht. Pa të menduar racional formimi i tij intelektual do të ishte i mangët dhe suksesi në jetë nuk do të ishte i sigurtë dhe i garantuar.

Të menduarit racional është baza e nisjes së të menduarit filozofik. Ky i dyti është procesi për të zbuluar të vërtetën. E vërteta filozofike zbulohet përmes filozofisë, e vërteta shkencore zbulohet përmes përvetësimit të shkencës dhe e vërteta fetare zbulohet përmes besimit fetar.

Mësuesit tanë vazhdojnë të përdorin terminologji të vjetër në procesin e edukimit. Nëpër tekste, gjithashtu, ka plot koncepte që janë të kapërcyera. Kjo ndodh edhe për shkak të kulturës që ata/o kanë marrë në shkollën e lartë, si dhe të kualifikimit ndër vite. Mirëpo, sot është koha e ndërtimit të njohurive dhe e zbulimit të vërtetës përmes metodologjisë dhe metodave shkencore. Koha e transmetimit të dijes është e kapërcyer.

Hapi i parë për ta ndryshuar këtë situatë është jetësimi i reformës kurrikulare të ndërtuar mbi qasjen (përafrimin) me kompetencën. Është e nevojshme të ndryshohet edhe referenca për përmbajtjen dhe metodologjinë e procesit të edukimit duke u larguar nga filozofia e biherioverizmit drejt filozofisë së konstruktivizmit.

AGIM LEKA

Një vend të vogël, por jo më pak të rëndësishëm, zënë **rekomandimet** që kam paraqitur në libër. Ato, besoj, do t’u shërbejnë jo vetëm nxënësve, studentëve, mësuesve dhe lexuesve të tjerë të nderuar, por edhe politikëbërjes për procesin mësimor edukativ.

PJESA E PARË

TRANZICIONI NGA MENDIMI SINKRETIK
TE BESIMI FETAR DHE MENDIMI RACIONAL

I. 1. Mendimi parafilozofik

Edhe në parahistori njerëzimi kishte mendimin e vet. Ky mendim është i sintetizur në mitologjinë e çdo populli. Termi “*mitologji*” [mythology] është përdorur gjatë viteve 1375-1425, pra në fund të Mesjetës. Është fjalë e përbërë nga “*mythos*” dhe “*logos*”.

Po t’i marrim të dyja së bashku, del se mitologjia është disiplina që studion mitet, gojëdhënat, rrëfimet, prejardhjen e tyre dhe veçoritë e pasqyrimin të realitetit në to. Në jetën shpirtërore të njerëzimit, mitologjia u shfaq si një shprehje e mendimeve për botën dhe jetën, për gjithçka që e rrethonte njeriun.

Fjala “*mythos*” rrjedh nga greqishtja e vjetër që do të thotë diskutim, rrëfim, përrallë, gojëdhënë.

“*Logos*” do të thotë fjalë, arsyetim, shkencë. Në teologji [theology] “*logos*” është fjala e Perëndisë, ose parimi i arsyes hyjnore dhe i rendit krijues. Në psikologjinë e Jungut [Carl Gustav Jung] “*logos*” është parimi i arsyes dhe i gjykimit.

Kur themi mitologji kuptojmë:

1. Një trup mitesh që një popull ka krijuar,
2. Mitologjia përmbledh të gjitha mitet (tërësia e miteve),
3. Disiplina që studion mitet,
4. Një grup tregimesh, traditash apo besimesh që janë mbledhur rreth një personi, ngjarjeje ose institucioni të caktuar.

Aristoteli⁽²⁾ shkruan: “Qenia njerëzore (homo sapiens) filloi të mendojë filozofikisht, sepse filloi të çuditet (habia), siç bëjmë edhe ne tani. Kjo është arsyeja pse mitformuesit janë gjithashtu filozofë, nga mënyra se si ata kompozojnë mitet”.

Filozofia dhe shkencat e tjera sociale, si antropologjia, sociologjia, psikologjia, shkencat krahasuese etj., kanë objekt të tyre mitet.

Mitet kanë ekzistuar para se njeriu të ndërtonte mendimin filozofik^{1*}. Mitet e këtij niveli janë mitet arkaike. Njerëzit e shpjegojnë botën në mënyrë naive. Është një përvojë thjesht vetjake dhe fare empirike. Njeriu është ende një pjesë e pandarë e natyrës. Ende mendja njerëzore nuk koncepton, pra, nuk abstragon ose nuk e largon emërtimin e sendit nga vetë sendi.

Filozofët përmes mendimit filozofik kanë vërtetuar dhe argumentuar se mendimi mitik ishte mendim sendor dhe njerëzimi i kohës së miteve të lashta ishte primitiv (shumë fillestar); ishte në nivelin e foshnjërisë (fëmijëri) së tij.

E në qoftë se do të ndërpresim për pak argumentimin tonë, le të bëjmë këtë reflektim:

Të gjithë kemi kaluar fëmijërinë tonë. Jemi prindër dhe gjyshër të fëmijëve dhe të nipërve e mbesave. Fëmija sapo fillon të ngrihet në këmbë mban në dorë një laps apo një letër të bardhë dhe fillon të shkarravisë! Më pas ai fillon të *“pikturojë”*.

Ai ende nuk e di se macja, lepuri veshgjatë, janë kafshë (koncept), por i vizaton ato dhe qesh e gëzohet.

Lërin fëmijët tuaj të vizatojnë atë që i pëlqen. Lëreni fëmijën tuaj që, pasi ka parë diellin, ta vizatojë në letër; pasi ka zgjatur duart, të kapë hënën, siç ta vizatojë në letër; pasi ka parë topin e futbollit, ta vizatojë dhe pastaj të rrëzohet mbi të, ndonëse nuk e di se si luhet futboll.

Krijoni mundësinë që të shikojë revista me ngjyra për fëmijë (jo për të rritur) dhe pastaj të bëjë çfarë dëshiron.

Mos i jepni në dorë fëmijës suaj, që ende nuk ka shkuar në shkollë, telefonin tuaj që të shikojë botën virtuale. Ai ka nevojë të përjetojë në mënyrën e vet botën reale të sendeve dhe jo botën e virtualitetit, sepse do të zhgënjehet kur të kuptojë dallimet midis tyre.

Në qoftë se fëmija nga mosha 2-3 vjeç do të fillojë të stërvisë duart e gishtat përmes vizatimeve e lodrave, duke prekur botën e sendeve konkrete (jo virtuale), me siguri në moshën 6-7-vjeçare ai do të jetë i suksesshëm në të shkruarit e gjuhës së folur dhe në formimin e koncepteve abstrakte përmes fjalëve e gjykimeve fëmijërore.

Mendoni një fëmijë që nuk ka stërvitur dorën në këtë mënyrë, sepse në fillim të foshnjërisë ka përdorur vetëm telefonin e mamit. Në moshën 6-vjeçare i duket e pamundur të ushtrojë duart e të bëjë format e ngatërruara të germave të alfabetit të gjuhës amtare.

Të mësuarit e shkrimit për këtë rast është një kalvar i vërtetë. Këtë gjë ai e ka bërë gjate tre viteve, vetëm me një prekje të lehtë të ekranit të telefonit, kompjuterit, tabletës. Nxënia e të shkruarit është së pari një veprimtari e trurit. Por edhe ushtrimi i duarve për këtë qëllim është veprimtari e trurit. Fëmija është e vetmja qenie e gjallë që lind me mendje.

Prandaj nevojitet të respektohet rendi natyror edhe në edukimin e foshnjërisë njerëzore. Vizatimet janë mendime sinkretike. Ato janë “*art*” primitiv.

A nuk themi ne që një skicë në murin e një shpelle ku kanë banuar njerëzit primitivë, të parët tanë, është e bukur? Po dhe duam ta fotografojmë.

E pra, ruani edhe ju vizatimet e para të fëmijës suaj. Edhe ai pas 80 vitesh, kur t’i shikojë, do të reflektojë për mendimin foshnjor dhe do t’ju urojë juve qetësi në atë botë.

Edhe në kohën tonë ka fise primitive, të cilët për çdo dru të pyllit kanë një emër, sepse nuk kane ende një koncept/abstraksion për të gjitha, siç është fjala “*pemë*” në gjuhën shqipe.

Në këtë stad zhvillimi njeriu (fëmija ose njeriu primitiv) nuk dallon të tërën nga e veçanta, nuk dallon kohën nga hapësira. Këto mite janë sinkretike. Domethënë në to janë në një të vetme edhe njohuri empirike për natyrën, edhe ide morale, edhe besime primitive fetare, edhe koncepte naive për të mirën e të keqen, për të bukurën dhe jo të bukurën etj.

Në stadin e dytë të saj shoqëria njerëzore primitive formon mitet klasike. Këto janë mitet kur shoqëria njerëzore ka krijuar edhe dijen filozofike, edhe dijen shkencore dhe kur ka arritur të ketë një perceptim artistik të botës.

Mitet e para kanë qenë ato për qenien [“*being*”, *entity*”, “*Dasein*”, “*being qua being*”] dhe pas tyre janë krijuar mitet për prejardhjen (mitet etiologjike). Më pas ka ardhur koha e miteve për heronjtë dhe për kozmogoninë

Sidoqoftë, të gjitha mitet primitive janë një mendim naiv, sinkretik dhe iluzionist.

Stadi i tretë e mitologjisë janë mitet moderne ose mitet urbane që vazhdojnë edhe sot e kësaj dite. Këto mite kanë të bëjnë me njohjen iluzore të botës.

Në grupin e miteve futen patjetër edhe mitet me natyrë fetare. Besimet e para kanë qenë besime te kafshët (animizmi), ose te dukuritë e natyrës (natyrizmi).

Animizmi dhe natyrizmi konsiderohen edhe fetë e para primitive të njerëzimit.

Më poshtë do të argumentojmë se mitet dhe feja e më pas filozofia e shkenca janë zhvilluar në vazhdimësinë e tyre të natyrshme si pjesë integrale e kulturës mendore, shpirtërore dhe materiale të njerëzimit që nga primitiviteti deri në ditët tona.

Duke studiuar historinë dhe mendimin filozofik të Lindjes dhe të Greqisë së lashtë është vërtetuar se ka lidhje natyrore mes këtyre dy “botëve” edhe në fushën e mendimi filozofik.

Grekët e kohës së Herodotit (shek. V p.l.k.) i dallonin popujt e tjerë të lindjes, si egjiptianët, indianët, persët nga gjuha e folur dhe nga mitet (kultura) dhe i emërtuan “barbarë”, ose, të ndryshëm (të tjerë).

Mirëpo këta popuj, që nuk flisnin gjuhën greke të lashtë dhe vinin nga vende të panjohura për grekët, kishin kulturë dhe mendim po aq të pasur sa edhe kultura dhe mendimi i civilizimit grek.

Argumenti historik kronologjik, që është një argument shkencor, tregon lidhjen e mendimit grek me mendimin filozofik egjiptian.

Një argument për këtë na jep Platoni kur vë në gojën e priftit egjiptian një mit i cili nuk është një mit autokton grek. Madje ka autorë dhe mendimtarë, edhe filozofë, të cilët argumentojnë se mendimi filozofik grek ka ardhur në këtë vend nga Lindja e lashtë.

Hipoteza e tyre bazohet te realiteti i kohës së lashtë të kolonizatorëve egjiptianë, të cilët më vonë studiuan në shkollat greke antike.⁽³⁾

Sipas Herodotit, mjaft nga emrat e perëndive greke kanë ardhur nga Egjipti. Emri i Poseidonit erdhi nga Libia. Edhe mjaft mite të kozmogonisë janë mite egjiptiane. Cilësitë transhendente të Faraonit të Egjiptit tregojnë lidhjen e mendimeve filozofike greke dhe egjiptiane.

Kontakti i Perandorisë së vjetër të Egjiptit (Dinastia IV) me Greqinë fillon që në kohën e neolitit të Kretës (2600 p.l.k.).

Veprat artistike dhe ikonografia e shek. XVII p.l.k. tregojnë për lidhjen e kulturës Minoane me dinastinë XIII të Egjiptit.

Mes viteve 670 p.l.k. dhe 570 p.l.k., koha e faraonit Psammetichus, mercenarët grekë kundër Asirisë, ndërtuan kampin e tyre në perëndim të Deltës dhe përhapën qytetërimin e Miletit aty.

Ata kontribuan në pajisjen e tempujve dhe shtuan gjithnjë e më shumë komunikimin kulturor përballë kulturës persiane të kohës.

Në vitin 332 Egjipti u pushtua dhe u grabit nga Maqedonia. Në vitin 305 Egjipti sundohet nga faraoni grek. Në vitin 30 p.l.k. vdiq Kleopatra VII, e fundit sundimtare egjiptiane.

Grekët e lashtë e ndanë filozofinë nga besimet popullore mitologjike spekulative. Ky proces bëri që në të ardhmen feja të ishte më shumë filozofike sesa mitologjike.

Ndryshe ndodhi në Greqi ku feja e tërhoqi filozofinë në fushën e vet. Këtu feja filloi të absorbohet ose të përfshihet në filozofi, apo në rastin më të mirë, u krijua mundësia e zhvillimit paralel, të besimit fetar dhe të filozofisë e, më pas, edhe të shkencës.

Në Lindje nuk u zhvillua arsyetimi racional i pastër, por feja dhe filozofia u përzien mes tyre.⁽²⁾

Gjithë popujt në kulturën e tyre kanë thurur me një gjuhë të pasur poetike përralla, legjenda, mite nga më të bukurat e më fantastiket. Në to u këndohet zanave të malit, orëve, sirenavë të detit, hyjnive, gjysmëhyjnive, heronjve, zotave etj.

Tregohet për dragonjtë, kuçedrat, gjarpërinjtë e forca të tjera çudibërëse. Është e natyrshme që në foshnjëri njeriu të krijonte një realitet të dytë fantastik për të shpjeguar atë realitet që jetonte, por që ishte i pafuqishëm ta shpjegonte e ta zotëronte në kushtet e një zhvillimi tepër primitiv ekonomik, kulturor, shkencor, teknik, intelektual etj.

Mitologjia është konsideruar si *“parafilezofi”*. Pra, mendimi parafilezofik është pasqyruar dhe materializuar te mitologjia. Nëpërmjet miteve njerëzit përpiqeshin jo vetëm të shpjegojnë dukuritë e natyrës, por edhe të gjenin kyçin për t’i zbërthyer, qoftë edhe në fantazi, këto forca të fshehta që vepronin në mënyrë kaq të pakuptueshme në jetën rreth e rrotull tyre.

I bukur është krahasimi i mitologjisë me Araknën duarartë, endësja e pëlhurave më e dëgjuar në të gjithë lashtësinë.

“Mitologjia është shpikje, fantazi e ndezur e pjellore që end si Arakna duarartë, e cila endte në pëlhurat e saj tablo të mrekullueshme plot ngjarje e bëma, pasione e drama të fuqishme sipas modelit të jetës njerëzore”.⁽⁴⁾

Sa më i vjetër të jetë miti, aq më i fortë tingëllon në të fitorja e njerëzve kundër forcave të natyrës.

Në fillimet e saj mitologjia ishte më e thjeshtë, mbizotëronin kryesisht figurat e kafshëve e më pak ato të bimëve. Në fazat e para hyjnitë ishin në

trajtë kafshësh të egra [therimorfe], [anthroponymy] dhe në trajtë drurësh (dendromorfe).

Dihet se hyjnitë antropomorfe (me trajtë njeriu) janë të një stadi më të vonë në historinë e feve.

Në disa fise Zeusi, para se të bëhej mbret i Olimp, ishte shqiponjë. Në disa të tjerë ishte qukapik; Hera ishte lopë; Atena ishte buf dhe Artemida ishte arushë.

Shndërrimi, kalimi nga mitet therimorfe e dendromorfe në mite antropomorfe, nuk është bërë menjëherë dhe në mënyrë të papritur. Do të ishte gabim të mendohej në këtë mënyrë.

Ja si e përcakton studiuesi⁽³⁾ A. Krappe në librin ““Studime të mitologjisë dhe folklorit gjerman” [Etudes de mythologie et de folklore germaniques]: “Do të ishte gabim, megjithatë, të mendohej se është fjala për një shndërrim të papritur e të menjëhershëm.

Ajo është më tepër një kalim shumë i ngadalshëm dhe krejt gradual. Mjaft elementë të mbetur më vonë tregojnë, në pjesën më të madhe të rasteve, nivelin theromorf dhe dendromorf që ka paraprirë fetë antropomorfe.

Ndonjëherë kafsha, dikur vetë zoti, bëhet shok besnik, si p.sh. shqiponja e Zeusit, bufi i Atenës, gjarpri i Demetrës” etj.

Ky shndërrim gradual i miteve është tregues i rritjes së forcës së intelektit njerëzor dhe i aftësisë së tij për shpjegimin e dukurive natyrore e shoqërore që ndeshen në jetën e përditshme.

Mite dhe legjenda kanë krijuar të gjithë popujt e botës.

Për një mitologji të pasur përmenden asirët e lashtë. E pasur është mitologjia kozmogonike, në të cilën shpjegohet origjina e trupave dhe dukurive kozmike.

Në Upanishadet indiane thuhet se kozmosi u krijua nga një kalë. Prej kokës së kalit u krijua agimi mëngjesor, prej frymëmarrjes era, prej mishit toka, prej flokëve bimët dhe bari.

Rrëfimet mitologjike mbështeten tek besimi. Në historinë e mitologjisë më e njohur u bë mitologjia e lashtë greke, paralel i ngjashëm i së cilës është mitologjia romake.

Mitologjia te grekët u krijua me një transparencë e bukuri të veçantë. Ajo është e thjeshtë dhe jo e ndërlikuar si te popujt e Lindjes, të cilët krijuan figura të frikshme hyjnish, të mbytura në misticizëm, me trajta të çuditshme e disi të llahtarshme.

Në mitet greke me bërthamë filozofike, siç është ai i kozmogonisë (i krijimit të gjithësisë) që zuri fill nga Kaosi, nga i cili, si pjesë që e përbënin, u veçuan me radhë Gea (toka), Erosi (dashuria), Urani (qielli) deri te Zeusi e më tutje.

Sistemi mitologjik që flet për zanafillën e krijimit të gjithësisë dhe hyjnive është interesant, sepse tregon se si në gjirin e mitologjisë fshihet një intuitë filozofike.

Figurat mitologjike të Kaosit, Geas, Erosit janë pararendëse të koncepteve filozofike të materies, hapësirës, lëvizjes etj.

Perënditë e Olimpit personifikonin në fillim forca e dukuri të natyrës, kishin karakter kozmik.

Zeusi në fillim ishte perëndi që hidhte rrufe dhe shi e shkaktonte shtrëngatën, Poseidoni ishte perëndia e deteve dhe Hades i nëntokës.

Karakter kozmik kishin edhe fëmijët e Zeusit që jetonin bashkë me të në Olimp. Afërdita ishte në fillim vetëm perëndeshë e pjellorisë, Artemida e kafshëve të egra dhe e gjuetisë, Atena personifikonte shkrepitimin.

Më vonë Zeusi dhe perënditë e tjera morën edhe funksione shoqërore dhe filluan të jetonin si njerëzit në tokë.

Të gjitha këto tregojnë se mitologjia e lashtë pagane, gjatë rrjedhës së kohës, ka pësuar ndryshime të ndjeshme në strukturën e saj të brendshme. Kjo mitologji është në varësi të shkallës së zhvillimit të jetesës së fiseve primitive.

Megjithëse dallimi midis mitit dhe arsyes është tepër i qartë, është e vështirë të përcaktosh natyrën dhe ecurinë e mendimit mitik, aq sa për këtë nocion është zhvilluar një debat që ka shoqëruar tërë historinë e filozofisë.

Filozofët grekë gjetën një pikë mirëkuptimi në vlerësimin e zhvillimit të të menduarit mitik. Ata e akuzuan këtë mendim për një mungesë të plotë të provave logjike.

Kur themi se mitologjia është parafilozofi, do të thotë se filozofia është kalim [transition] nga mendësia e lashtë, e shprehur me mendim sendor, te mendimi racional i bazuar në ligjet llogjike.

Mendim sendor [syncretic thought] është niveli paralogjik i mendimit, i cili në fushën e psikologjisë konsiderohet mendim foshnjor. (Jean Piaget, 2018).

I vetmi përjashtim i pjesshëm ishte Platoni, i cili nuk ngurroi të shfrytëzonte aftësinë e mitit për të thënë të pathënën, pra, për të shprehur sipas hamendjes ndjesi kaq të thella, saqë kapërcejnë kufijtë e arsyes dhe për këtë mund të shprehen me vërtetësi”.

Feja e krishterë ka huazuar shumë nga mitologjia. Të shikojmë vetëm legjendën rreth Krishtit, i cili vdes dhe ringjallet. Ajo na kujton perëndinë e bimësisë Dionisin, i quajtur perëndi e natyrës, që vdes dhe ringjallet. Por, ndërsa Dionisi hokatar e optimist është zoti i vreshtarisë dhe i verërave dehëse, i gëzimit dhe i orgjive, Krishti është mishërimi i asketizmit, i heqjes dorë nga gëzimet e jetës.

Njeriu përcaktohet nga dualizmi midis shpirtit dhe trupit. Te ai është e pranishme kundërvënja e pazgjidhshme, sepse shpëtimi i shpirtit kërkon ndrydhjen dhe pastrimin e trupit.

Pas vdekjes së trupit kalon një gjykim, i cili mund të jetë ndëshkim, që do të thotë rimishërim i ri, apo një shpërblim, d.m.th. çlirimi përfundimtar nga cikli i rimishërimit, për t'u kthyer në një shpirt të pastër.

Në thelb, Orfizmi^{2*} i premtonte ithtarit të çlirojë atë çka është hyjnore, qiellore dhe mirësinë brenda tij, për ta kthyer në një shpirt të pastër, shpirt hyjnor, ashtu sikundër ishin të gjithë në zanafillë.

Siç e shikojmë, mendimi parafilezofik ka lindur dhe është zhvilluar së bashku me mitet.

Prandaj mitet dhe mitologjitë i quajmë si parahistoria e filozofisë. Mendimi parafilezofik gjeti pasqyrimin në to.

Ato tregojnë përpjekjet e para për të pasqyruar, sistemuar dhe interpretuar në një farë mënyre përvojën jetësore të njerëzve, vrojtimet e tyre tërë habi dhe kërshtëri, dëshirat dhe aspiratat e tyre jetësore, lufta për të shpjeguar dhe zotëruar dukuritë e shumta natyrore dhe shoqërore.

Në mitologji vendin e parë e zë fantazia e jo argumenti. Mitologjia nuk mund të jetë dije filozofike, apo filozofi. Ajo është më shumë besim ose produkt i shpirtit, sesa i mendjes njerëzore. Mitologjia rezulton të jetë feja më e lashtë e bazuar në besim. Vendi që zë argumenti në të është i diskutueshëm.

Koncepti i “mendimit mitik” ka ekzistuar rreth 100 vjet më parë. Mendimtarët e kuptojnë mitin si një alegori (Creuzer). Në mes të shek. XIX, grupi i filozofëve me këtë pikëpamje themeloi shkollën mitologjike dhe e interpretuan mitin si alegori. Etërit e kësaj filozofie janë Max Mueller, A. Kuhn dhe dishepujt të tyre.

Në vitet 1830 August Komte [Isidore Marie Auguste François Xavier Comte (1798-1857)] paraqiti doktrinën për zhvillimin e tre fazave e të menduarit.⁽⁸⁾

Faza e parë quhet “gjendja foshnjore të mendjes”. Këtë mendim ai e quan mendim teologjik. Ai shfaqet në format të tilla si: fetishizëm, politeizëm dhe monoteizëm. Mendimi teologjik ka nivel të lartë në shprehjen si dhe në paraqitjen e pasioneve njerëzore.

Psikologjia e ka krahasuar njeriun primitiv me fëmijën e kohës moderne. Ndërsa shoqëritë me kultura të zhvilluara i krahason me njeriun e maturuar ose të rritur.

Erns Kasier [Ernst Cassirer (1874-1945)] ka shkruar dy vëllime për mendimin mitologjik. Ato titullohen “Filozofia e formave simbolike” [*Philosophy of Symbolic Forms*] dhe “Mendimit mitik” [*Sprache und Mythos* 1925].

Megjithatë, mbizotërues është mendimi i Kantit i cili nënkuptonte se njohuritë e fituara nuk konsiderohen në varësi të faktorëve të jashtëm, por nga faktorët e brendshëm të qenies njerëzore (intuita transhedentale).

I. 2. Miti filozofik

Miti i parë filozofik është Miti i Prometeut. Prometeu është iluministi i parë që ka luftuar kundër Zeusit e sistemit të Olimpikut dhe i jep njeriut dritë e kulturë.

Mitet⁽⁶⁾ dhe mitologjia kanë lëvizur nëpër kohëra. Mitologjia vërtet është një strukturë specifike, por ajo ka lidhjet e saj me zhvillimin ekonomik e social, si edhe me artin, pikturën, letërsinë, zejt etj.

Nuk duhet mbivlerësuar mospërputhja e miteve me ngjarjet historike, sepse fantazia distancon vështrimin e qartë. Gjithashtu deformimi i fakteve është i pashmangshëm, duke kaluar gojë më gojë dhe gjatë mijëvjeçarëve.

Mitologjia ka frymë narrative, piktoreske dhe stil poetik të fjalës. Faktet e narracionit mitologjik janë të marra nga të gjitha pjesët e jetës njerëzore dhe imagjinare.

Në mitologji ka shumë alegori e simbole, ku përshkruhen shumë veti njerëzore: guximi, zgjuarsia, frika. Ka mite të përshkruara me tendencë, ashtu gjen edhe krijimtari naive.

Është e natyrshme të kuptohet se çdo mit përmban një ide ose mesazh. Por mesazhi mitologjik ka shumë dallim nga mesazhi filozofik dhe mesazhi i fesë.

Kjo do të thotë se filozofia është tranzicion nga mendimi mitik në mendimin racional. Ndërkohë nuk ka një tranzicion të mesazheve mitike në mesazhe filozofike.

Filozofia nuk është vazhdimësi e miteve. Mendimi filozofik është niveli më i lartë i mendimit përmes të cilit shpjegohen mesazhet e miteve dhe mesazhet e besimeve.

Mitologjia ka mendime përgjithësuese e sintetizuese, të cilat shfaqen përmes fantazisë dhe shprehjeve të figurshme. Sigurisht ka edhe plot elementë fetarë.

Miti dhe historia përzihen me njëri-tjetrin si narracion (tregim) për të kaluarën.

Dijetari Xhejm Frajzer [Sir James George Frazer (1854-1941)] e konsideron mitin si një formë të mendimit (evolucion kulturor) të hershëm fetar ose shkencor. Ai është dijetari i parë që përshkroi marrëdhëniet midis miteve dhe riteve dhe paralelet e tyre në krishterimin e hershëm.

Të njëjtën pikëpamje kishte për mitin edhe historiani rumuno-amerikan Mirkea Elade (1907-1986). Sipas tij, miti është një orvatje e njeriut për të shpjeguar origjinën fetare ose një kthim tek akti fillestar i krijimit.

Ky shpjegim është kundërshtuar nga Malinovski [Bronisław Kasper Malinowski (1884-1942)], i cili e trajton mitin si përligje të sistemit shoqëror.

Levi Straus [Claude Lévi-Strauss (1908-2009)] ka argumentuar se nuk ka rëndësi përmbajtja e mitit, por struktura. Kjo e fundit zbulon proceset universale të mendimit njerëzor.

Frojdi dhe Jungu janë marrë gjerësisht me mitet, por më shumë në planin psikologjik sesa në atë filozofik.

Në çdo qytetërim të lashtë mitologjia është një pararendëse e filozofisë. Janë gjetur në dokumentet e shkruara të qytetërimeve antike të Mesopotamisë mite me përmbajtje filozofike për origjinën e tokës, qiejve, të perëndisë e të njeriut.

Natyra në këto mite paraqitet si një teatër dhe rezultat i përplasjes së fuqive hyjnore ose të forcave elementare të personifikuara.

Në një mit babilonas Marduku, i shpallur mbret i perëndive, ndeshet me Tiamantin (monstër femër), që mishëron fuqitë e çrregullimit, kthimit në kaos.

Marduku, me ndihmën e erërave, e vret Tiamantin, e hedh gjysmën e saj në ajër dhe formon qiellin. Ai rregullon vendin dhe lëvizjen e yjeve, fikson vitin e muajt, krijon racën njerëzore dhe ndan fatet e privilegjet.

Rregulli i zbuluar nga njeriu është rezultat i disfatës së kaosit. Ai është shprehje e një sovraniteti hyjnor që garanton rregullsinë e ditëve, rregullin

e stinëve, hierarkinë e fuqive natyrore, favorizon ose privilegjon disa njerëz apo disa vende.

Mendimi mitologjik, në kohë, nuk mund të veçohet prerazi me filozofinë. Në veprat e filozofit të lashtë grek, Platonit, kur flitet për shpirtin, zanafillën, për trupëzimin e shpirtit, ka plot mite. Sistemi i ideve të tij është i ndërtuar mbi bazën e “mitit të shpellës”.

Më tej mund të themi se filozofia morale e Sokratit ka “shpirt ungjillor”, pikërisht sepse përdor gjerësisht mendimin mitik.

Henri Bergson analizon lidhjen e mendimit mitologjik me filozofinë dhe thekson se mitet jo vetëm janë të lidhura me mendimin filozofik, por për të shpjeguar botën, janë në harmoni me të si një simfoni muzikore.

Ai jep jo vetëm shembullin e mësipërm të Sokratit e Platonit, por edhe të filozofëve të periudhës aleksandrine apo të neoplatonizmit.

Në epokën e bronzit ndodhi diferencimi mes dijes fetare nga dija filozofike, mes priftit e filozofit. Në këtë epokë u ndanë edhe zejet nga njëra-tjetra.

U diferencua dija shkencore nga filozofia dhe nga feja. Pavarësisht se termi laicizëm është shumë i vonë, ne mund të themi se me Sokratin dhe Aristotelin fillon laicizmi.

Duke lexuar filozofin Xhilles Granger [Gilles Gaston Granger (1920-2016)] kuptojmë se në botën antike, për një grek, romak dhe, më pak për një egjiptian ose babilonas, objektet teknike të zakonshme që kishte përreth nuk ishin aspak shenja të shkencës.

Ai i referohet Aristotelit, i cili dallon shkencën (epistema) nga ajo që e quan “tekne” dhe që shpesh e kanë përkthyer “art” në kuptimin më të gjerë të fjalës.

Mendimi i Aristotelit na çon në mendimin se shkenca duhet të dallohet nga “tekna”. Ajo, ndryshe nga “arti”, mund të shprehet në një gjuhë dhe të jetë e komunikueshme me anë të të mësuarit/nxënit.

Por ajo dallohet mbi të gjitha nga natyra e objekteve ndaj të cilave zbatohet. Ai që është objekt i shkencës ekziston domosdoshmërisht. Do të thotë se objekti i shkencës nuk mund të jetë i supozuar.

Duke krahasuar llojet e krijimtarisë mitike më të vërtetën, besueshmërinë dhe autoritetin, po japim skemën e mëposhtme të hartuar nga një studiues i njohur botërisht⁽⁵⁾. Mund të nxirrni vetë përfundime për treguesit e mësipërm.

Mitet, e vërteta, besueshmëria dhe autoriteti

LLOJET E MITEVE	E VËRTETA	BESEUSHMËRIA	AUTORITETI
FABULA	Nuk e synon	Përpiqet	Nuk kanë lidhje
LEGJENDA	Konsideron të tillë fillimin	E pabesueshme	Synon atë
HISTORIA	Është zbulim i të vërtetës historike	E besueshme	Dije autoritare
MITI	E vërteta është shpirtërore	Beson me shpirt. Dije naive. Produkt joracional.	Dije sinkretike

I. 3. Dija filozofike

Dija filozofike përftohet e ndërtohet në fushën e ideve ose në fushën e filozofisë. Është dija më e sigurtë dhe më e thellë për njohjen e botës, sepse konceptet e saj janë transhendente. Lënda [substrat] e tyre është ideja dhe jo sendi apo fakti. Aty ku fillon arsyetimi përmes faktit, aty nis edhe largimi (shmangia) nga konceptet filozofike (filozofia).

Duke realizuar njohjen ndërtohet mendimi për botën, për gjithësinë dhe shoqërinë njerëzore. Njohja filozofike është procesi i “të menduarit filozofik. Përmes këtij procesi njeriu e kupton botën në mënyrë filozofike.

Grekët e lashtë dijen filozofike e quajnë “urtësi” dhe filozofët “të urtë”. Nëse përdorim gjuhën e përditshme, atëherë “të urtët” janë të mençurit.

Dija filozofike ose sofia (sophy) u bë dije racionale ose mendim filozofik nga Aristoteli. Kështu që ne mund t’i njësojmë gjate përdorimit të përditshëm termat “dije filozofike” dhe “mendim filozofik”. Natyrisht duke kuptuar se dija është në mendje dhe mendimi është të vepruarit e mendjes. Sipas Aristoteli njeriu është qenie e dalluar nga një parim racional. Ai thekson se qenia njerëzore udhëhiqet nga një parim racional (greqisht: λόγονᾷον), që e dallon nga bimët dhe kafshët.

Filozofi neoplatonik Porfir e përcaktonte njeriun si një “kafshë të vdekshme racionale”. Përkufizimi i njeriut si kafshë racionale ishte e zakonshme në filozofinë shkollore të Mesjetës.

Dija filozofike qëndron midis teologjisë dhe shkencës. Është si teologjia kur ajo gjykon për probleme të cilat sot e kësaj dite janë të pavërtetuara nga shkenca ose praktika (nga njerëzimi). Por dallohet nga feja, e cila, më së shumti, ka karakter spekulativ.

Duke u bazuar në tri fusha të dijes: fetare, filozofike dhe shkencore, ne mund të diskutojmë edhe për tri të vërtetat. Dija fetare na jep të vërtetën fetare, dija shkencore na jep të vërtetën shkencore dhe dija filozofike shpreh të vërtetën filozofike.

Dija filozofike është e afërt me atë shkencore, kur i drejtohet arsyes njerëzore. Të dyja janë ndërtuar mbi parimet e ligjet logjike. Dija filozofike është “prodhim” i arsyes, ndërsa feja është “prodhim” i shpirtit të njeriut. Dija e saktë i përket shkencës, dogma i përket teologjisë dhe në mes është filozofia. (Tabela 1.7).

Ka shumë probleme të mëdha që shkenca nuk u përgjigjet në mënyrë shteruese.

Ja disa prej tyre: A është bota e ndarë në mendje e lëndë ose materie? Çfarë është mendja? Po lënda? Ç’është materia? Universi është progres apo qëllim? A ka ligje objektive? Ç’është njeriu? Ç’janë e mira dhe e keqja? Ç’është progresi dhe regresi? Ç’është jeta dhe vdekja? Ç’është mençuria? Po koha dhe hapësira? etj.

Pyetje të tilla, dhe shumë e shumë të tjera, bashkë me përgjigjet përkatëse, janë detyra e filozofisë.

“Në qoftë se shkenca do të fliste pa filozofinë, ajo do të ishte e verbër dhe filozofia pa shkencën do të ishte boshe”.⁽⁹⁾

Që të njohësh një njeri, familje, komunitet, komb, shoqëri, duhet të njohësh filozofinë e tyre. Kjo sepse rrethanat jetës përcaktojnë filozofinë dhe filozofia ndikon në ndryshimin ose në rrjedhën e rrethanave.

Pra, dija filozofike nuk ka lindur njëherazi e së bashku me njeriun. Ajo lidhet me zhvillimin e jetës njerëzore.

Në gjithë historinë e njerëzimit, qysh nga parahistoria, ekziston një mendim elementar ose mendim empirik fillestar. Është një mendim naiv (dije naive).

Natyrisht është mendim logjik dhe teknik, sepse njeriut i duhet të punojë, të sigurojë ushqimin, të bëjë një vegël për gjah apo një lloj veprimtarie (një lloj pune).

Mendimi racional është prezent te njeriu primitiv. Edhe ai bën veprime magjike, edhe kur mendon e sillet si politeist. Ky është një “kafshë “ që mendon.

Kjo fazë e zhvillimit njerëzor të njohjes është ky racionaliet shumë të fragmentuar. Ai më shumë është në dobi të veprimeve praktike, sesa për të krijuar një mendim, i cili mund të shprehet me fjalë.

Tjetër gjë është, të kesh mendim empirik, apo logjik, dhe tjetër gjë të prodhosh ide. Krahasoni një fëmijë të vogël me një njeri të rritur.

Fëmija mund të belbëzojë emrin “nënë” në gjuhën kombëtare, por ai nuk prodhon dot një ide. Pra ai ende nuk e ka idenë e nënës.

Filozofia vjen dhe shfaqet nga errësira e njohjes. Hegeli thotë: “Filozofia vjen gjithnjë shumë vonë.

Si një mendim mbi botën, ajo shfaqet vetëm kur realiteti e ka përmbushur dhe mbaruar procesin e formimit ose të konceptualizimit.

Të njëjtën domosdoshmëri ne e tregojnë edhe historia. Edhe kjo ndodh pikërisht në kohën e pjekurisë së qenieve, në të cilën ideja shfaqet ballë për ballë reales dhe, pasi e ka kapur thelbin e saj, rindërton në formën e një perandorie idesh.

Vetëm në fillim të muzgut pulëbardha e Minervës fillon fluturimin e vet.⁽⁹⁾

Dija filozofike ka dy tipare:

1. Abstragimi

Filozofia nuk merret me aktualitetin, faktin, të përditshmen, të rëndomtën, as edhe me hyjnoren, por i drejtohet sferës së mendësisë dhe të domosdoshmërisë.

Është bota e ideve ajo që ne quajmë filozofi.

Abstraksioni është proces konceptual, ku rregullat dhe konceptet e përgjithshme rrjedhin nga përdorimi dhe klasifikimi i shembujve specifikë, simboleve të drejtpërdrejta (realë ose “konkret”), parimeve ose metodave.

Rezultati i këtij procesi është koncepti që funksionon si emër i përbashkët për të gjitha konceptet e nënrenditura dhe lidh çdo koncept me një grup, fushë ose kategori.

Abstraksionet mund të formohen duke filtruar përmbajtjen e informacionit të konceptit ose të fenomenit të vëzhgueshëm, duke zgjedhur vetëm aspektet që janë të rëndësishme për një qëllim të caktuar, subjektivisht të vlerësuar.

Për shembull, abstraksioni i fustanit të martesës është koncept i ndërtuar mbi idenë e përgjithshme të nxjerrë nga informacioni mbi dasmat, zakonet, vlerat estetike, respekti për vajzën dhe djalin etj., por pa shmangur karakteristikat e veçanta të qepjes dhe përdorimit të fustanit.

2. Kërkimi i të vërtetës

Gjatë historisë janë krijuar e krijoen shumë rryma e shkolla filozofike (filozofi).

Secila synon të zbulojë të vërtetën. Filozofia ka objektiv dhe përdor ato metoda shkencore që të çojnë drejt të vërtetës

Fjala “e vërtetë” në gjuhën angleze dhe gjermane ka kuptimin “*besnik*”. Në gjuhë të tjera ka kuptime të ndryshme, por karakteristikë e përbashkët është përfshirja e cilësive (vlerat) “*besnik*”, “*besnikëri*”, “*sinqeritet*”, “*fisnikëri*”, “*ndershmëri*”, “*mirënjohje*”, “*mirëbesim*”.⁽¹⁰⁾

Të njëjtin kuptim ka edhe në gjuhën shqipe. Vërtetë, ashtu siç është, i përgjigjet realitetit, i/e sigurtë, i saktë, nuk ngjall dyshim, besnik deri në fund, i hapur, i çiltër, i drejtë dhe jo i shtirur, etj.

I. 4. Mendimi filozofik dhe mendimi shkencor

Filozofia dhe shkenca janë dy fusha (disiplina) të dijes. Mund të shprehemi se dija filozofike dhe dija shkencore janë të ndryshme nga njëra-tjetra. Filozofia është dija e parë dhe u bë baza e shkencës, e njohur dikur si filozofi natyrore.

Platoni është filozofi i parë që e bëri dijen filozofike disiplinë të veçantë ose disiplinë më vete. Ai sistemoi gjithë dijen parasokratike në një disiplinë të mirëfilltë teorike.

Edhe dijet shkencore janë dije teorike por, ndryshe nga ato filozofike, bazohen e ndërtohen mbi fakte të provueshme, mbi prova e eksperimente.

Filozofia ndërtohet mbi ide të kulluara. Edhe idetë substanciale të Aristotelit, sic do të lexojmë më tutje, janë ide teorike. Ato prodhojnë filozofi (mendim filozofik) përmes racionalitetit, argumentit, reflektimit.

Konceptet jo substanciale prodhojnë ideologji, përmes besimit dhe zbatimit të dogmave të padiskutueshme.

Në sistemin arsimor nuk duhet njësuar fusha e dijes me lëndën mësimore. Shpesh këto dy koncepte njësohen sidomos në literaturën shkollore. Dhe kjo vjen sepse fjala anglese “*subject*” [*substrat*] përkthehet në gjuhën shqipe “*lëndë*”. Madje është bërë traditë që “*lënda*” të njësohet me termin “*përmbajtje*”. Edhe sot e kësaj dite, në shkresa shkruhet fjala “*lënda*” në vend të fjalës “*përmbajtja*” e dokumentit.

Nëpërmjet dijeve ndërtohen kërkime dhe studime filozofike dhe studime shkencore. Prandaj termat “*filozofi*” dhe “*shkencë*” nënkuptojnë edhe termat “*studim filozofik*” dhe “*studim shkencor*”.

Fusha e filozofisë dhe fusha e shkencës janë të lidhura dhe komunikuese me njëra-tjetrën. Ato përdorin ide, koncepte, gjykime, arsyetime, pyetje dhe analiza.

Dallimi kryesor qëndron në mënyrën se si ato njohin botën, si ato zbulojnë të vërtetën në fushën e tyre.

Filozofia kërkon të vërtetën filozofike dhe shkenca kërkon të vërtetën shkencore.

Përmes njohjes së botës ato ndërtojnë njohuri. Shkenca është e angazhuar me fenomenet natyrore, ndërsa filozofia përpiket të kuptojë natyrën e njeriut, qenien ose materien njerëzore [human being] dhe ndërgjegjen si dhe marrëdhënien që ekziston midis dy koncepteve.

“*Shkenca*” vjen nga një fjalë latine [*scientia*], ndërsa “*filozofia*” rrjedh nga *Phi* [*Φ*]. “*Phi*” është simboli i “raportit të artë” dhe tregon lidhjen mes filozofisë dhe shkencës, siç e ka argumentuar Aristoteli.

1. 4. A. Mendimi filozofik është integral

Fjala greke “*sofi*” [*sophiā/σοφία*] në gjuhën angleze përkthehet “*wisdom*” që do të thotë “*dije teorike*” e cila ka në përmbajtje edhe vlerën. Në gjuhën shqipe fjala “*wisdom*” duhet të shqipërohet “*mençuri*” ose “*urtësi*”.

Ajo është nxjerrë nga një mendje e ndritur, gati hyjnore, dhe kapet më shumë nga intuita sesa nga logjika formale, apo logjika e njerëzve të zakonshëm. Të tillë ishin “shtatë të urtit” e Greqisë antike në shek. VI p.l.k. (Fig. 1. 4).

Një tipar i përbashkët midis dy dijeve qëndron në faktin se ato të dyja përpiqen të shpjegojnë situatat dhe të gjejnë përgjigje.



*Fig. 1. 4. Mozaiku me shtatë të urtët e Greqisë antike.
Në qendër është Kaliopa dhe më lart me nr. 12, Sokrati*

Filozofia e bën këtë duke përdorur argumentime logjike, ndërsa shkencë përdor të dhëna empirike.

Shpjegimet e filozofisë janë të bazuara në argumente e parime, ndërsa shkencë përpiket të shpjegojë bazuar në të dhënat, rezultatet, eksperimentet, faktet e vëzhgueshme dhe provat objektive.

Dija shkencore përdoret për raste që kërkojnë vlerësim empirik, ndërsa filozofia përdoret për situata ku matjet dhe vëzhgimet nuk mund të aplikohen. Shkencë gjithashtu merr përgjigje dhe i dëshmon ato si objektivisht të drejta apo të gabuara.

Pyetje objektive përfshihen edhe në filozofi dhe ajo u jep përgjigje njëlloj si edhe shkencë. Mund të ketë pyetje objektive që, ndonëse janë përfshirë në filozofi, përgjigjen e tyre mund ta japë vetëm shkencë.

Në këtë rast filozofia shërben si ndriçues i rrugës së kërkimit të të vërtetës. Kjo do të thotë se shërben si metodologji dhe/ose metodë.

Përveç gjetjes së përgjigjeve, filozofia përfshin edhe gjenerimin e pyetjeve. Ndërkohë, shkenca është e angazhuar vetëm për t'iu përgjigjur pyetjeve.

Filozofia ndërton njohuri përmes të menduarit; shkenca bën të njëjtën gjë duke vëzhguar.

Shkenca është gjithashtu një studim i definuar, në kontrast me filozofinë, e cila mund të zbatohet në shumë fusha të gjera të disiplinës.

Edukimi procesi i kultivimit të njeriut. Qëllimi i edukimit është formimi dhe pjekuria e njeriut ose ta bëjë njeriun të mençur/të urtë (*të ditur dhe të mirë*) mbi bazën shkencore të formimit duke përdorur metodologjitë më të suksesshme dhe të arrijë të kuptojë sa më qartë tri botët: botën fizike, botën biologjike, botën shpirtërore (*botën e vetes/vetëveten*).

Mendimi integral është mendim kritik që reflekton e integron dijet (shkencore e jo shkencore) dhe vlerat njerëzore. Ai ndërtohet përmes edukimit integral. Realizimi i mendimit integral është kompetenca: sistemi integral i njohurive, aftësive dhe vlerave, përmes të cilit, personi ndërton dhe zgjidh situatën.

Mendimi integral është proces dhe produkt i kërkimit filozofik që realizon qenia dhe fillon me njohjen e tri botëve: universi fizik ose subuniversi i qenieve të gjalla; bota e përvojës së vetëdijshme që është produkt i evolucionit, dhe bota e produkteve të mendjes njerëzore.

Njëherazi, është proces shpirtëror dhe ka në bazë besimin, dashurinë, të bukurën dhe të mirën e përgjithshme; është edhe proces kulturor që ndërvaret nga mjedisi, rrethanat dhe kushtet e jetës sociale.

Në kuptimin filozofik, mendimi është produkti më i rëndësishëm dhe më i sofistikuar i tre departamenteve të mendjes së mësuesit: perceptimi, intelekti dhe dëshirat.⁽¹¹⁾

Ai është i kushtëzuar nga abstragimi dhe eksperiencia. Shtrihet përtej mendjes, është i lidhur organikisht dhe realizohet nëpërmjet arsytimit.

Qenia njerëzore mendon duke arsyetuar, por mendimi realizohet edhe në shumë forma dhe mjete të tjera njerëzore.

Mendimi është themeli i qytetërimit aq sa është edhe produkt i këtij qytetërimi. Kjo do të thotë se mendimi njerëzor nuk ka një pronësi (një autorësi private në vetën e parë në numrin njëjës). E thënë ndryshe për rastin tonë, mësuesi i izoluar nga komuniteti, nuk ka mendim.

Mençuria është të kuptuarit racional, i shprehur me gjykime dhe arsyetime sintetike logjike dhe aftësia për të arritur përfundime inteligjente [intelligent conclusions], përmes përjetimeve shpirtërore të vlerave objektive dhe/ose subjektive të krijuara nga njeriu.

Mendimi filozofik është racional sepse ndërtohet mbi bazën e arsyetimit dhe kalon nga e vërteta e parë, tek e dyta, deri në gjykimin përfundimtar (konkluzion).

Në dallim nga mendimi empirik, i cili argumenton gjitha dijet nëpërmjet përvojave, kërkimi racional nisët nga e vërteta e parë dhe në vijim, duke zbatuar ligjet logjike, zbulon të tjera të vërteta (pluralizmi i të vërtetave).

Aristoteli zbuloi racionalitetin si funksioni përcaktues i qenieve njerëzore. Ai argumentoi se përmbushja më e lartë e jetës njerëzore, ose eudaimonia (lulëzim ose mirëqenie), arrihet përmes harmonisë së racionalitetit me virtytin.

Ky koncept vazhdon zërë vendin parësor në diskutimet moderne filozofike, në fushën e dijeve psikologjike dhe veçanërisht në fushën e moralit e të etikës.

Pas më shumë se 14 shekuj, Aristoteli u përkthye në latinisht dhe Thoma Akuini [Thomas Aquinas] lidhi filozofinë antike me Krishterimin.

Dekartit [René Descartes] me filozofinë e tij ("mendim kartezyan"), çliroi njerzimin nga dogma teologjike dhe magjia mesjetare.

Pas Rilindjes Europiane dimensionin e shtrirjes së mendimit u kufizua në kuadratin e boshteve kartesiane me gjeometrismin e B. Spinozës (Baruch Spinoza) dhe monadat e G. Lajbnizit [Gottfried Wilhelm (von) Leibniz].

Mendimi i qartë, vendosur në kuadrat të saktë shkencor, u bë jo vetëm modeli i mendimit përfundimor evropian, por edhe mendim universal [Latin, 'I think', in Descartes's formula (1641) "*cogito, ergo sum*" '*I think therefore I am*']. Ky është parimi i krijimit, i ekzistencës së qenies nga të menduarit ose nga vetëdija.

Shën Augustini i Hipo [Saint Augustine of Hippo 354-430] e ka dhënë i pari këtë parim të mendimit duke barazuar mendimin me besimin.

Me kalimin e kohës lindi nevoja e përfaqësjes së re përtej tre dimensioneve. Përveç thellësisë, shtrirjes dhe gjerësisë, duhej edhe transhendenca ose e përtejshmja.

Xhon Lok [John Locke (1632-1704)] kuptoi hendekun midis mendimit racional dhe vlerave njerëzore. E përkthyer në terma filozofikë, ky hendek ishte midis të vërtetës dhe të moralshmes.

Immanuel Kanti (1724–1804) krijoi dimensionin e ri, transhendencën, dhe hodhi bazën e mendimit kritik. Mirëpo, edhe ky, ndonëse shënonte nivel të lartë pjekurie të mendimit perëndimor, kishte “defekt” të madh.

Ai i dha një dimension të ri të vërtetës filozofike, por nuk kishte krijuar një hapësirë për të gjitha vlerat e qytetërimit modern Europian.

Racionaliteti ishte bazë e nevojshme dhe e domosdoshme për vlerat e tjera, por nuk ishte i mjaftueshëm.

Mendimi racional shprehte në mënyrë të qartë dhe saktësisht vetëm të vërtetën shkencore. Ndërkohë mungesa e ekuilibrit mes objektives dhe subjektives e gjymton mendimin racional.

Mendimi nuk mund të konsiderohej vetëm si veprimtari subjektive (R. Steiner, 1916), sepse janë edhe vlerat.

E ato nuk janë produkt i mendjes njerëzore, ndërkohë që janë produkt i qenies dhe i marrëdhënieve njerëzore objektive dhe subjektive.

Në epokën moderne, pasmesjetare, morali, feja, politika, arti kishin krijuar vlera dhe vazhdonin të krijonin vlera të reja, të cilat, përveç racionalitetit, kishin edhe dimensione të tjera.

Këtë krizë të mendimit e zgjidhi mendimi kritik (Ennis, 1991), që është përjasje jo vetëm me të vërtetën shkencore racionale, por edhe me të gjitha vlerat shoqërore të qytetërimit evropian e, sidomos, me vlerat morale.

Edhe në shek. XIX mendimi u ndërtua mbi bazën e proceseve intelektuale racionale. Kjo do të thotë se të mësuarit, konkluzionet induktive dhe deduktive dhe arsyetimi bazuar mbi lidhjen shkakësore, supozohet në përgjithësi të jenë të njëjtë për të gjitha grupet/racat njerëzore.

Mirëpo nuk ndodh kështu me vlerat njerëzore, sepse vlera njerëzore të njëllajta nuk bashkëshoqërohen nga mendime racionale të njëjta.

Babai i fenomenologjisë moderne të shek. XX, Huserli [Edmund Husserl], midis mençurisë/urtësisë [wisdom] dhe diturisë (teoria) qëndroi te “mendoj pra jam” e Dekartit.

Me argumentin e zhvillimit të shpejtë të shkencave dhe të teknologjisë Ken Vaiber [Ken Wilber, 2007] përcaktoi katër dimensionet e mendimit integral: “Unë”, “Ne”, “Ai”, “E atyre” (numri shumë veta e tretë).

Ky agregat shprehet me ekuacionin $\Sigma[Ne] + \Sigma[Unë] = \Sigma[Komunitet]$. (¹*)

Mendimi integral ose mendimi multidimensional, si produkt i qenies integrale njerëzore, shtrihet përtej mendjes dhe, në këtë stad, ai shndërrohet në vetëdije.

Vetëdijesimi integral është proces që lind dhe zhvillohet bashkë me mendimin. Por ai mund të realizohet vetëm në epokën globale.

Në këtë epokë mendimi kapërcen nivelet e racionalitetit apo të arsyes (arsyetimit), shtrihet drejt dimensioneve të reja cilësore dhe realizohet si mendim integral refleksiv.

Ai është një mendim me integritet, që do të thotë se përmban, jo vetëm një racionalitet të lartë, por përfshin në masë të konsiderueshme vlerat njerëzore.

Kur flasim për zhvillim të mendimit drejt integritetit dhe integritetit të tij nuk mund të përdorim termin “*evolucion*”.^{4*}

Në kontekstin e zhvillimit të mendimit ne përdorim termin “*tranzicion*” dhe “*lëvizje tranzitive*”, duke iu shmangur termit klasik “*të evolucionit*”.

Dallimi i dy termave është parimor, sepse termi *evolucion* është i lidhur me lëvizjen e ndërprerë nga kapërcimet (hopet) cilësore dhe sasiore; ndërsa lëvizja tranzitive është e pandërprerë, zhvilluese dhe progresive.

Mendimi dhe gjuha njerëzore janë ndërtuar dhe zhvilluar pa ndërprerë. Procesi i zhvillimit ecën jo në vijë të drejtë, por, është lëvizje tranzitive që kalon nga një nivel në tjetrin, sipas vijës së lakuar dhe të pandërprerë.

Skica e mëposhtme tregon dallimin mes dy llojeve të lëvizjes përmes vijave të drejta dhe vijave të lakuara (vijat eliptike).




Figura 1. 4. Vijat eliptike [*elliptic line*] simbolizojnë lëvizjen e mendimit

Edukimi filozofik (EF) realizohet përmes kërkimit filozofik që është mjeti/ruga e/i edukimit, përmaset e të cilit shtrihen në qenien, mendjen dhe shpirtin e njeriut.

Përmbajtja e EF janë dijet, njohuritë, aftësitë ontologjike, gnoseologjike, si dhe besimet, qëndrimet e përjetimet shpirtërore të vlerave (Ë.R. Houston 1969).

Në gjuhën gjermane termi “*edukim*” përfshihen tri dimensione të diskursit filozofik: metoda/metodologjia, të mësuarit (*upbringing*), formati i zhvillimit të mendjes (*Bildung*).

EF realizohet në fushën e edukimit të përgjithshëm dhe të edukimit profesional.

Në qoftë se i referohemi mësuesisë, përmasat filozofike të edukimit të mësuesit janë përmbajtja dhe forma e mendimit dhe e besimit, sistemi i vlerave njerëzore në të cilat ai/ajo orientohet në kryerjen e misionit.

Të menduarit filozofik është shtylla bazë e ndërtimit të kompetencës themelor në gjykimin, vlerësimin dhe vendimmarrjen për vërtetësinë dhe dobishmërinë e njohurive, aftësive, shprehive dhe vlerave.

Përmes EF njeriu mendon dhe reflekton.

Sokrati dhe Konfuci, më pas Platoni dhe Aristoteli, janë jo vetëm filozofët e parë, por edhe mësuesit e parë të njerëzimit, për ndërtimin e mendimit filozofik në Lindjen e Largët dhe në Perëndim.

Për të njohur shkaqet e fenomeneve, të sendeve apo të ngjarjeve, ne realizojmë kërkimin shkencor. Pra, natyra është objekti i kërkimit shkencor.

Njohuritë shkencore fillojnë të ndërtohen me atë që ne dimë. E dimë nëpërmjet mendimit të thjeshtë ose “*apriori*” që është i pavarur nga çdo përvojë konkrete. Pas këtij hapi, fillon njohja “*aposteriori*”.

Kjo do të thotë se ne veprojmë kështu:

Mësuesi pyet: Sa është shuma e numrave 80 dhe 30?

Nxënësi shkruan: $80+30=110$

Në vijim, mësuesi nuk mund ta pyesë nxënësin se pse kjo shumë është e vërtetë.

Në qoftë se ai i bën këtë pyetje nxënësit, ky i fundit do të shpenzojë kohë dhe energji mendore t’i provojë mësuesit rrugën e mbledhjes sipas rendeve të shifrave, nga rendi më i ulët tek ai i larti si dhe renditjen e shifrave të shumës.

Këtë përvojë ai e ka nxënë dhe e zbaton në mënyrë automatike, gati në mënyrë të pavetëdijshme.

Pra, përgjigja për pyetjen e dytë të mësuesit nuk ndihmon aspak në formimin shkencor të nxënësit.

Tjetër gjë është në qoftë se mësuesi do t'i kërkonte nxënësit: si e provoni ju këtë rezultat? Në këtë rast nxënësi do të bënte veprimin: $110-30=80$.

Pyetjen e parë të mësuesit, që cituam më lart, I. Kanti e konsideron një budallallëk.^{5*}

A nuk do të ishte një budallallëk biseda e mëposhtme me fëmijën e shkollës fillore:

Mësuesi/prindi: Sa bëjnë 7×7 ?

Nxënësi: Bëjnë 49

Mësuesi/prindi: Pse, si gjete?

Pyetja krijon për nxënësin një situatë absurde dhe ai është gati të thotë gjithë tabelën e shumëzimit, por nuk mund të gjejë shkakun ose pse-në e çdo rezultati.

Edhe në rastin e parë, edhe në të dytin mësuesi/prindi nuk di që e vërteta aksiomatike apo dija apriori është vërtetuar nga vetë përvoja ose eksperiencia jetësore e fëmijës dhe e prindit/mësuesit.

Me këtë fillon mendimi shkencor dhe vazhdon me dijen post apriori.

Koncepti i shkakësisë lidhet gjithmonë me përvojën. Njohuritë ndërtohen duke studiuar natyrën dhe duke gjetur lidhjet e shkak-pasojës.

Në natyrë ka vetëm lidhje shkak-pasojë dhe nuk ka mrekulli. Mendimi ndërtohet duke organizuar konceptet, duke u bazuar fort në parimet dhe ligjet e logjikës (shkenca e të menduarit).

Dija e shkencës natyrore është ajo që shpreh atë që ndodh, shpreh atë që matet. Edhe dija në shkencat humane (shkencat shpirtërore) apo në histori shpreh faktin që ndodh apo që është dhe që, pra, ka vlerë dhe jo që supozohet.

Kërkimi shkencor nuk mund të përfundojë me pohimin “është një forcë e mbinatyrshme që ndërhyr te natyra”.

Një përfundim i tillë nuk mund të jetë rezultat i kërkimit shkencor që ka objekt natyrën dhe jo Zotin.⁽¹²⁾

Edukimi shkencor është edukimi me përmbajtje shkencore. Kjo do të thotë se ai është proces përmes të cilit ndërtohen dhe forcohen njohuri, vlera e qëndrime të bazuara drejtpërdrejt në të vërtetat shkencore.

Edukimi ose formimi shkencor është proces që zhvillohet në shkollën publike që është e ndarë nga feja, pra, është shkollë laike në përmbajtje dhe është institucion sekular (e ndarë nga shteti).

Natyrishisht që edukimi shkencor realizohet edhe në çdo shkollë jopublike, pra, shkollë private të ndërtuar sipas ligjeve të shtetit jofetar (shteti i të drejtës).

Edukimi shkencor ka filluar qysh kur dija shkencore u nda nga dija joshkencore.

Ndarja (*mëvetësia*) e shkencës nga filozofia dhe besimi fillon me mendimin parasokratik (shek. VI-V p.l.k).

Procesi i diferencimit të dijeve shkencore është thelbi i organizimit të procesit shkencor (shkenca) i cili, përmes institucioneve publike, arriti kulmin në gjysmën e dytë të shek. XIX (Th. H. Huxley & J. Tundall, 1870).

Në vitet '90 të shek. XIX edukimi shkencor u standardizua përmes kurrikulës së shkollës publike.

Nga fillimi i shek. XX deri në ditët tona mësuesit dhe publiku kanë rritur gjithnjë e më shumë vetëdijshmërinë e tyre për mundësinë e edukimit shkencor dhe rolin në jetën e përditshme.

Kuptimi shkencor i fenomeneve kryesore të jetës nga çdo njeri është bërë kërkesë jo vetëm e dëshirueshme, por edhe e domosdoshme për të zgjidhur problemet e jetës së përditshme dhe për të siguruar e garantuar zhvillim të qëndrueshëm në të ardhmen.

Pra shkenca gjithnjë e më shumë po dominon jetën tonë të përditshme (B. J. Del Giorko, 1969, fq. 191).

Metodologjia dhe metodat e edukimit shkencor janë të shumëllojta dhe studiohen nga disa shkenca/disiplina sociale dhe veçanërisht nga pedagogjia dhe nëndegët e saj.

Problemi i vendit të fesë në shkencën e edukimit nuk është i njëjtë me vendin e fesë në shkencë.

Është krejt e pamundur të nxirret përfundim shkencor se feja ka vend në shkencë.

Kjo do të thotë se shkenca e edukimit më shumë ka kuptimin e kufijve të edukimit sesa të një shkence.

Edukimi shtrihet (përfshin) një fushë dhe jo një lëndë apo disa lëndë të veçanta, qofshin vetëm shkencore. Për shembull, ne e pranojmë se etika ka një rol të rëndësishëm në shkencën e edukimit.⁽¹³⁾

Ndërkohë ligjet morale nuk janë të dhëna nga Perëndia, e megjithatë ato nuk janë më pak të rëndësishme në procesin mësimor edukativ.

Njerëzit jetojnë gjithë jetën në mënyrë të moralshme dhe nuk presin që të shpërblehen ose të dënohen në botën e tjetër (M. Hack 1922-2003).

Prej kësaj nxirret përfundimi se edukimi shkencor në shkollë nuk mund të ndërtohet duke bërë shpjegime që kanë premisë gjyqime fetare për njeriun, njerëzimin e historinë e jetës në tokë.

Mësuesit duhet të ndërtojnë situata problemore që kanë premisë bazë teorinë shkencore të evolucionit të jetës dhe jo teorinë e kreticionizmit dhe të inteligjencës krijuese.

Parimet e shkencës na çojnë te njohuritë për krijuesin e njeriut, i cili është krijuesi i shkencës dhe kjo është mënyra që njeriu mund ta shikojë Zotin si objekt të shkencës, nëse është përballë tij. Mirëpo, Zoti nuk është tokësor.

Nivelet e lëvizjes transitive për ndërtimin e mendimit kritik

- Dituria dhe/ose njohuria
- Krahassimi
- Aplikimi
- Analiza
- Sinteza
- Zbatimi (vënia në jetë)

I. 5. Edukimi i vlerave njerëzore

Vlerat njerëzore janë idetë, mendimet, parimet, standardet, bindjet, sjelljet, qëndrimet, besimet dhe udhëzimet që njerëzit ndjekin në jetën e përditshme.

Vlerat mendohen dhe mendimi që është thelbi i tyre nuk i krijon ato. Vlerat njerëzore janë themeli mbi të cilin është ndërtuar jeta e njerëzve. Ato përcaktojnë pozicionin e çdo individi në komunitetin e vogël dhe në të gjitha pozicionet e shoqërisë.

Mbi bazën e vlerat njerëzore është ndërtuar edhe shumica e ligjeve dhe legjislacioni në çdo sistem demokratik. Në qoftë se mendimet individuale nuk janë të detyruara për individët e tjerë, vlerat duhet t'i kenë të gjithë anëtarët e komunitetit.

Parimet janë pjesë e vlerave, sepse edhe kur janë individuale, duhet të jenë të dakorduara nga shoqëria. Parimi është themeli mbi të cilin bazohen vlerat dhe integriteti i tyre.

Vlera nuk mund të jetë individuale dhe as e izoluar. Ajo manifestohet nga individi në shoqëri dhe është referencë për individin.

Ky i fundit nuk mund ta masë veten vetëm me parimet, bindjet apo besimet e veta personale. Njeriu është qenie sociale që bart, shfaq, orientohet dhe udhëzohet nga vlerat e shoqërisë ku ai jeton.

Vlerat nuk mund të jenë të lindura dhe të trashëguara. Ato janë produkt i edukimit që nga lindja e njeriut. Deri në moshën 6-7 vjeç vlerat nguliten te fëmija, në adolehencë modelohen dhe më pas socializohen (Morris Massey, 1997).

Vlerat nuk mund të njësohen me virtytet që për shkak të përmbajtjes së tyre janë kategori morale. Termi moral “*virtyt*” (*vir, lat*) tregon standardin e lartë moral që arrin njeriu nëpërmjet sjelljes.

Vlerat mund të grupohen në “**vlera të orientuara**” dhe në “**vlera të paorientuara**”.

Vlera të orientuara janë vlerat sociale më shumë të dallueshme midis vlerave të tjera të një individi, grupi social, klase, komuniteti dhe/ose kombi.

Duke qenë më të pjekura, më të organizuara dhe më funksionuese se vlerat e tjera, jo vetëm e dallojnë bartësin nga të tjerët, por edhe e orientojnë në gjithë veprimtarinë dhe jetën. Këto vlera janë vokacioni i individit.

“Vlerat e orientuara” është përdorur si një term kyç nga Firence Kluckhohn në vitet 1950.⁽¹⁴⁾

Teoria e vlerave të orientuara në ShBA është përdorur si një metodë/metodologji për integrimin e grupeve sociale multikulturore. “Vlerat e orientuara” dhe “vlerat e paorientuara” janë objekt studimi nga shumë disiplina, si: psikologjia, sociologjia, biologjia e mjekësia.

Disa “vlera të orientuara” të mësuesit mund të ishin: idealizmi, solidariteti, besimi, dashuria pa kushte, kujdesi për fëmijët, ruajtja e trashëgimisë, lumturia, respekti, kënaqësia për punën, modestia etj.

Ndryshe nga profesionet e tjera, “vlerat e orientuara” të mësuesit/es shtrihen në të gjitha fushat e jetës, si në punë, familje, jetë, shoqëri, politikë, besim fetar, komunikim publik, qytetari, komunitet, formim intelektual etj.

“Vlerat e paorientuara”, duke qenë prezente te çdo individ, komunikojnë mes tyre dhe janë në marrëdhënie komplementare me “vlerat e orientuara”.

Në epokën e integritit global teoria e vlerave të orientuara konkurren filozofinë e ndarjes në vlera dhe antivlera.

I. 6. Edukimi fetar

Që nga antikiteti fjalët “*religio*” dhe “*threskeia*” janë përdorur nga Cicero dhe Eusebius. “*E shenja*” në disa fe është subjekt i trajtimit shkencor, në disa të tjera nuk është.

Në rastin e dytë “*e shenja*” është në nivelin e alkimisë dhe të astrologjisë, madje me plot gabime që shfaqen si halucinacionale dhe nuk kanë asnjë lidhje me shkencën.

Feja është subjekt i shenjtë dhe, si në format më perfekte, ashtu edhe në ato më pak perfekte, gëzon nderimin më të lartë të njerëzve.

Fjala “*Zot*” përdoret me nderim nga çdo njeri, qoftë kristian, mysliman, hinduist, apo edhe ateist. Njerëzit normalë kurrë nuk ofendojnë Zotin.⁽¹⁵⁾

Kompetenca fetare (religious competence) është qëllimi themelor i edukimit fetar. Përdoret termi “kompetencë fetare” sepse me këtë kuptohet se të mësuarit dhe të nxëniet e fesë është fokusuar në tërë zhvillimin njerëzor të individit.

Personi ka formim fetar (edukim fetar) kur zotëron kompetencën fetare, pra, kur gjithë zhvillimin (qenien) mendor, shpirtëror dhe fizik (trupor) e ka ndërtuar mbi bazën e fesë (besimi fetar) që i përket. Mbi këtë bazë ai ka ndërtuar të gjitha marrëdhëniet shoqërore: familjare, komunitare, marrëdhëniet e grupit apo të shtresës etj.

Ky edukim ka pjesë organike të tij tolerancën aktive të individit apo të grupit. Kjo do të thotë se ka ndërtuar, zotëron dhe orientohet nga kompetenca morale për dialog dhe mirëkuptim me të gjithë njerëzit pa paragjykuar besimin ose mosbesimin e tyre.

Edukimi fetar përfshin gjithashtu zotësinë për të pranuar pluralizmin fetar dhe diferencimin në mënyrë konstruktive dhe paqësore.

Nxëniet nga feja dhe rreth fesë fillon me faktin se ka besime të ndryshme të njerëzve, se jo të gjithë besojnë si unë, se feja ekziston në mënyra të shumta.⁽¹⁶⁾

Ndërtimi i kompetencës fetare fillon me premisën bazë të arsyetimit që është “Zoti krijoi gjithësinë”. Kjo fjali (premisë) “është e vërtetë dhe nuk ka nevojë të provohet” (K Popper. 1995).

Premisa bazë është deklarim që përshkruan thelbin ose esencën e një sendi, dukurie, apo fenomeni.


Esenca e Zotit është qenia (ekzistenca) dhe gjithëpërfshirja hyjnore. Ai nuk është qenie tokësore.

Qasja e edukimit shkencor me fenë ka ndryshuar që nga fillimet e laicizmit dhe sekularizmit. Por gjithmonë është vazhduar e do të vazhdohet në udhën e forcimit të këtyre arritjeve.

Qasja sekulare e shkollës franceze që nga viti 2002 ka ndryshuar përmes kurrikulës, e cila ka përfshirë të mësuarit e faktit fetar (fait religieux) në aspektin empirik dhe objektiv.

Kjo do të thotë se feja vlerësohet si pjesë e historisë, gjeografisë, letërsisë, edukimit qytetar, artit, muzikës.

Termi “fakt fetar” (religious facts) është ndërtuar mbi një qasje konsensuale dhe nxit një trajtim të arsyeshëm dhe të logjikshëm të aspekteve të fesë si pjesë të qytetërimit njerëzor.⁽¹⁷⁾



Siç duket edhe në tabelë, nuk ka kufij të pakapërcyshëm midis fesë, filozofisë dhe shkencës, por ka mëvetësi (identitet) mes tri të vërtetave, origjinë dhe ura lidhëse të përbashkëta.

I. 7. Degët tradicionale të filozofisë

1. Ontologjia ose Metafizika apo Teoria e qenies.

Ontologjia [ontology] merret me parimet e para të rendit natyror dhe “përgjithësimet përfundimtare të intelektit njerëzor”. Ontologjia kërkon të identifikojë dhe të vendosë marrëdhëniet midis kategorive. Ajo u jep përgjigje pyetjeve të tilla, si:

Ç’lloje gjërash ekzistojnë? A ekzistojnë vetëm gjëra të veçanta ose a ekzistojnë edhe gjëra të përgjithshme? Si është e mundur ekzistenca?

Pyetje në lidhje me identitetin dhe ndryshimin e objekteve: Si ekzistojnë idetë nëse nuk kanë madhësi, formë apo ngjyrë? Një ide nuk shtrihet në hapësirë. Cila është hapësira? Cila është koha?

Ne përdorim termin “të vërtetat e matematikës”. Në ç’kuptim ekzistojnë shifrat gjeometrike? A janë pikat, linjat apo aeroplanët të vërtetë apo jo? Nga çfarë janë bërë? Çfarë është shpirti?

2. Logjika.

Është dija për rregullat, parimet dhe ligjet e mendimit racional.

3. Aksiologjia.

Teoria që studion vlerat në kuptimin e tyre filozofik ose metafizik.

Ajo studion natyrën e vlerave, lidhjet dhe dallimet e tyre nga dëshirat dhe interesat njerëzore, llojet dhe kriteret e vlerave, statuset e tyre shoqërore dhe ndryshimet që pësojnë ato në shoqëri. Aksiologjia zakonisht ndahet në dy pjesë kryesore:

Etika.

Studimi i vlerave në sjelljen njerëzore ose studimi i problemeve morale.

Estetika.

Studimi i vlerave dhe i kategorive estetike të artit dhe të natyrës, përvetësimi estetik i botës dhe shijet estetike.

4. Epistemologjia.

Është studimi i njohurive. Në veçanti, ajo studion njohuritë e natyrës, fushëveprimin dhe kufijtë e njohurive. Epistemologjia heton origjinën, strukturën, metodat dhe integritetin e diturisë. Merrni parasysh shkallën e të vërtetës së deklaratës “Toka është e rrumbullakët”. A varet e vërteta e saj nga konteksti në të cilin thuhet deklarata? Për shembull, kjo deklaratë mund të përkthehet: “Toka ngjan me formën e portokallit”; “Toka është sferike”; “Toka është një sferoid me polet të rrafshuara”.

Në qoftë se jemi në malin Himalaja, perceptimi ynë për formën e tokës nuk është identik me atë kur jemi nën nivelin e detit.

Prandaj, forma e saktë e tokës nuk mund të njihet. Pse, a nuk ndryshon forma e tokës nga veprimi i agentëve atmosferikë? Patjetër.

Skepticistët dhe relativistët thonë: “Nuk mund të përshkruaj saktësisht formën e tokës, dhe përfundimi logjik është se toka nuk ka formë”.

I. 8. Historia e filozofisë, themeli i formimit filozofik

Termi në gjuhën angleze është “*History of philosophy*”, në gjuhën gjermane është “*Geschichte der philosophie*” dhe italisht “*La storia della filozofia*”.

Ne mund të përdorim edhe termin histori e mendimit filozofik ose histori e filozofisë.

Pyetja që kërkon përgjigje është pse Historia e filozofisë është bazë për formimin filozofik?

Në përgjigje të saj vlen premisa se, termi filozofi përfshin pluralizëm pa fund të ideve, rrymave, shkollave dhe individëve që veç pikëpamjeve të përgjithshme filozofike, paraqesin e argumentojnë edhe plot ide, madje teori e doktrina filozofike.

Do të ishte naivitet të mendonim se formimi filozofik ndërtohet duke u bazuar në një filozofi të veçantë qoftë edhe më e thellë apo më e gjerë.

Prova e dështimit për këtë ishte keqpërdorimi nga stalinizmi i filozofisë marksiste, duke u njësuar me marksizëm-leninizëm dhe duke u zyrtarizuar si ideologji sunduese për edukimin e njeriut të ri socialist.

Historia e filozofisë është disiplinë e mirëfilltë teorike. Ajo synon të paraqesë historinë e formimit të filozofisë ose të mendimit filozofik, të

interpretojë zhvillimin e ideve filozofike në kohë e në vende të ndryshme, nga autorë dhe shkolla të ndryshme.

Këtu dijet paraqiten përmes narracionit, pra, në mënyrë përshkruese dhe historike, por kanë edhe karakter vlerësues.

Historia e filozofisë ka lindur së bashku me vetë filozofinë. Platoni dhe Aristoteli i dhanë asaj përmbajtjen dhe formën e një disipline të veçantë.

Gjatë Mesjetës kjo dije ishte pjese e skolastikës e cila e njësonte filozofinë me fenë. Ajo filloi në periudhën e hershme moderne, para revolucionit shkencor, i cili filloi në fund të Rilindjes e vazhdoi deri në shek. XVIII ose në periudhën e iluminizmit.

Botimi i librit të Nikolla Koperniku [Nicolaus Copernicus] “Mbi revolucionin e sferave qiellore” [De revolutionibus orbium coelestium] në vitin 1543 shënon fillimin e revolucionit shkencor.

Rilindja e filozofisë nisi të zhvillohet në Europën e viteve 1355-1650 me filozofinë e vonë të Mesjetës. Në shek. XIV-XV u ndikua fort nga figura të shquara si Alberty i Madh ose Alberty i Këlnit [lat Albertus Magnus], Thoma Akuinas [Tomas Akuinas], Uliam Ockham [Ëilliam of Ockham] dhe Marsilo Menardini [Marsilio Mainardini] nga Padova, si dhe nga filozofia e hershme moderne.

Filozofët zakonisht e ndajnë periudhën më hollësisht, duke filluar me filozofinë mesjetare e deri te filozofia e hershme moderne: Kjo do të thotë se asnjë shndërrim radikal nuk u zhvilluan në shekujt para Rene Dekartit [lat Renatus Cartesius].

Platoni dhe Aristoteli u bënë të njohur në Mesjetë, me përkthimet latine në Itali (shek. XV), sidomos me përkthimin e veprave të tij të plota nga Marsilio Ficino në Firence (1484).^{6*}

Petrarka [Francesko Petrarka] nuk ishte në gjendje të lexonte direkt Platonin, por ai e admironte shumë. Ai admironte poetët romakë: Virgili, Horace dhe Ciceron. Jo të gjithë humanistët e ndoqën shembullin. Petrarka kontribuoi në zgjerimin e “kanonit” të kohës së tij (poezia pagane më parë ishte konsideruar e pavlerë dhe e rrezikshme), diçka që ndodhi edhe në filozofi.

Në shekullin e gjashtëmbëdhjetë të gjithë ata që e konsideronin veten intelektualë lexuan Platonin dhe Aristotelin, duke u përpjekur t’i pajtonin të dy me njëri-tjetrin dhe me Krishterimin.

Skepticizmi dhe Pirronizmi bënë rikthim me Michel Montaigne. Lëvizja e stoicizmit bëri një ri-shfaqje mbresëlënëse në shkrimet e Justus Lipsius.

Në të gjitha këto raste është e pamundur të ndahen doktrinat pagane filozofike nga filtri i krishterë përmes të cilit ata u afruan dhe u bënë legjitime.

Në epokën moderne Hegeli e bëri historinë e filozofisë dije shkencore. Sipas tij, historia e filozofisë ka logjikën, ligjet dhe parimet e saja. Hegeli nuk e pranoi idenë se kjo dije është vetëm një përshkrim i ideve dhe shkollave filozofike. Kjo është disiplinë që studion ligjet e mendjes njerëzore. Nuk është vetëm një paraqitje.

Sa thamë më lart, Historia e filozofisë paraqitet si *metafilozofi (teori e teorisë)*, ose shumë e doktrinave ose doktrinë teorike që studion teoritë.

Mund të përdoret termi “*metateori*” edhe për filozofinë. Por më i përshtatshëm është për disiplinën e historisë së filozofisë.

Ka filozofë që filozofinë e quajnë shkencë të shkencave ose pemë me shumë degë. Këtë pikëpamje ka filozofi modern Rene Dekart.

Ky interpretim i gjerë i dijes filozofike ka bërë që të kemi edhe filozofi të shkencës, filozofi të artit, filozofi të moralit, filozofi të fesë etj.

Në këtë plan kjo shkencë duhet parë më shumë si një histori e ideve, sesa në kuptimin e përshkrimit historik të çdo shkolle ose rryme të veçantë.

Metateoria përdoret edhe për shkencat e tjera, si, p.sh., metamatematika, metakimia. Në këto raste ajo nuk mund të zëvendësojë filozofinë dhe as që mund të identifikohet me të. Është tjetër metateroia e një shkence dhe tjetër është filozofia e shkencës. Është tjetër teoria e fizikës dhe tjetër është filozofia e shkencës së fizikës.

Historia e filozofisë është pjesë përbërëse e gjithë historisë së shoqërisë dhe e mendimit njerëzor, që nga fillimet e deri në ditët tona.⁽¹⁶⁾ Ajo është baza për të studiuar të kaluarën e mendimit filozofik në dobi të përgjigjeve të pyetjeve të sotme “Ç’po ndodh me mendimin njerëzor?”, “Cila është e vërteta?”

Këto pyetje janë shtruar njëlloj që në agimin e njerëzimit e do të jenë gjithnjë në axhendën e kërkimit njerëzor. Njohja e shkrimeve filozofike, e autorëve të çdo kohe, e sistemeve filozofike është baza për t’u orientuar në rrugën e zbulimit të së vërtetës, është baza e orientimit, jo vetëm pragmatist gjithënjëror, por edhe utilitar e personal.

Shpesh pyesin: Pse duhet studiuar Historia e filozofisë? Filozofia është instrument i jetesës njerëzore. Kjo do të thotë se, nëse ndjek filozofinë e

asketizmit, atëherë do të sillesh e të jetosh si asket. Mund të jesh edhe një asket modern. Pra, kënaqesh me pak. Nëse do të ndjekësh hedonizmin, atëherë do të jeshë i tillë. Nëse beson vetëm materializmin do të jesh materialist.

Pas rënies së komunizmit në Shqipëri, por edhe në të gjitha vendet e Lindjes, u krijua kultura hedoniste e jetesës, e të menduarit, e të sjellurit, e të vepruarit, duke i harxhuar të gjitha paratë informale në dobi të kënaqësive materiale e shpirtërore.

Njerëzit vinin nga një shoqëri me privime të mëdha. Ata pësuan një deformim edhe shpirtëror, edhe trupor, edhe në veshje, në flokë, në të folur.

Shpërtheu një “luks” vulgar me makina luksoze. Shumica e njerëzve bëri të vetin një motiv negativ për t’u pasuruar brenda ditës me një normë fitimi maksimale, e cila ishte e papranueshme për një shoqëri kapitaliste klasike.

Qytetarët, jo vetëm shqiptarë, me shembjen e sistemit komunist u vunë përballë filozofisë së tregut, me të cilën ata nuk ishin mësuar. Kjo filozofi ishte e panjohur dhe e huaj për ta.

Historia e filozofisë të çon drejt agimit të mendimit teorik. Ajo u jep përgjigje pyetjeve: “Ç’është filozofia?”, “Ç’janë idetë?”.

Nëpër rrjedhën e mendimit filozofik janë krijuar shumë shkolla e rryma filozofike. Materialistë janë quajtur filozofët që në plan të parë, ose primare, quanin materien. Njihen materialistët e parë të Lashtësisë si materialistë vulgarë.

Ishte koha kur shkencat e natyrës ishin ende të pazhvilluara. Ata materialistë që vunë në bazë të gjykimeve filozofike mekanikën dhe fizikën janë materialistë mekanicistë. Filozofë të tjerë u quajtën materialistë dialektikë, sepse bashkuan materializmin e tyre me dialektikën.

Edhe dialektika vetë u paraqit edhe si dialektikë spontane e lashtësisë, edhe si dialektikë materialiste, edhe si dialektikë idealiste.

Një grup filozofësh janë deistët. Zoti [*deus*], sipas tyre, krijoi botën dhe pastaj për disa ekziston e për disa nuk ekziston.

Idealistët pranojnë si bazë fillestare idenë. Ata që idenë e quajnë objektive janë idealistë objektivë dhe ata që idenë e quajnë subjektive janë idealistë subjektivë. Po kështu ka edhe idealistë fizikë, idealistë fiziologjikë.

Idealizmi i Kantit është idealizëm kritik transhendental, sepse cilësitë e sendeve nuk kapen me anën e shqisave, por në mënyrë transhendetiale ose me anën e intuitës.

Idealizmi i Berklit është subjektiv, sepse në qendër ka “*unin*” ose subjektin njeri.

Idealizmi i Hegelit është objektiv dhe absolut. Boshti i filozofisë hegeliane është ideja absolute.

Sido që të jetë, historia e filozofisë tregon se nuk mund të ketë ndarje absolute të filozofëve dhe të shkollave në mënyrë definitive, duke u nisur nga një parim i vetëm.

Ndarje të madhe në dy shkolla filozofike bëri filozofia marksiste, duke u nisur vetëm nga raporti i materies me ndërgjegjen.

Ndarja nuk është e argumentuar as logjikisht, por është edhe antinatyrore. Interferenca dhe integrimi i dijes filozofike dhe i shkollave filozofike është një proces natyror, objektiv dhe i dobishëm.

Besimi lind te njeriu shumë kohë përpara dijes së tij. Kjo do të thotë se feja lind shumë më parë se filozofia. Filozofia u veçua nga teologjia në shek. VI p.l.k. në Greqinë e Lashtë. Në këtë kohë në Greqi u zhvillua racionaliteti i njohjes.

Njeriu tashmë nuk ishte një skllav për të siguruar ushqimin e përditshëm. Ka tashmë një veprimtari të gjerë shoqërore, e cila krijon hapësirën për mendimin teorik.

Ai fillon të reflektojë në mënyrë racionale për çdo veprim, për çdo dukuri natyrore, për çdo dukuri shoqërore.

Filloi ballafaqimi i ideve. Ky ballafaqim bëhet me racionalitet dhe me argument. Lindi kështu filozofia.

SHËNIME

- ^{1*} *Mendimi filozofik fillon me racionalitetin. Njeriu ka racionalitet, do të thotë, vepron në bazë të arsyes. Termi lidh epistemologjinë [epistemonikon, greek] ose shkencën [scientific deduction] me etikën. Vjen nga fjala arsyetim [reasoning (lat)], ose mendim [thinking] ose kalkulim [calculatio] ⁽⁶⁾.*
- ^{2*} *Orfizëm është emri i një grupi besimesh dhe praktikash fetare nga bota e lashtë greke, helenistike dhe thrake. Është vuajtja dhe vdekja e perëndisë Dionis nga Titanët. Dionisi i mitur vritet. Zeusi i godet Titanët me rrufe, duke i kthyer në hi. Nga hiri lind njerëzimi. Sipas besimit orfik njerëzimi ka natyrë të dyfishtë: trup dhe shpirt.*
- ^{3*} *Grupi shoqëror ku jemi integruar (NE) plus individët e tjerë të vetintegruar dhe me vetë identitet (UNI), ndërtojnë komunitetin e ri, i cili ka dimensione cilësore e sasiore më të mëdha se shumata matematikore e faktorëve të mbledhjes.*
- ^{4*} *Learning, inductive and deductive inference, and causal reasoning are generally presumed to be the same among all human groups. (R. E. Nisbett & Co. 2001).*
- ^{5*} *Termi që përdor I. Kanti në gjuhën gjermane dhe shumë të tjerë në gjuhën anglese, është i diskutueshëm se si mund të kuptohet. Duke u nisur nga konteksti i mendimit kritik, babai i të cilit është Kanti, duke krahasuar të njëjtin term në gjuhën anglese me kuptimin në shqip, kam përdorur fjalën “budallallëk”.*
- ^{6*} *Marsilio shkroi librin “Mbrotjtësit e paqes” [Defensor pacis, 1324] në kontekstin e luftës midis Papa Gjon XXII dhe Ludvigut të Bavarisë, kandidat për perandor i Perandorisë së Shenjtë Romake. Marsilio*

argumentoi pavarësinë e shtetit nga papati. Ai pajtohet me Aristotelin se, qëllimi i qeverisë është përmbushja racionale e dëshirës natyrore të njeriut për “jetë normale”. Shkon përtej Aristotelit kur mbron republikën dhe popullin e konsideron burimi legjitim të autoritetit politik. Sovraniteti qëndron te njerëzit, dhe populli duhet t’i zgjedhë, t’i korrigjojë dhe, nëse është e nevojshme, t’i heqë liderët. Demokracia, argumenton Marsilio, është forma më e mirë e qeverisjes, sepse tenton të prodhojë ligjet më të mençura dhe mbron interesat e përbashkëta.

REFERIME

1. K. E. 1999. *Rekomandimi i Këshillit të Europës* nr. 1396.
2. Aristotle. 1995. *Metaphysics* 982 b.
3. K. Schilbrack. 2002. *Thinking Through Myths. Philosophical perspectives*. Rotledge. New York & London.
4. M. J. Charleworth. 1972. *The religion and Philosophy. A Historical Approach*. Macmillan Palgrave London.
5. A. Krappe. 1918. *Etudes de mythologie et de folklore germaniques*. Paris.
6. A. Kocani. 1998. *Historia e shkencave. Gjeneza e shkencës dhe burimet e saj. Evolucionit i elementit teorik në nivelin e shkencës*. ShBLU. Tiranë. fq. 3-105.
7. B. Lincoln. 1992. *Discourse and Construction of Society: Comparative Studies of Myth, Ritual, and Classification*. Oxford University Press Inc.
8. A. Comte (1798-1857) është filozof francez dhe themelues i sociologjisë. Ka studiuar tri fazat e progresit të mendjes njerëzore: teologjike, metafizike dhe pozitive. Filozofia është pozitiviste. Dy veprat më të rëndësishme të tij janë: "Kursi i filozofisë pozitive" (1830-42) dhe "Sistemi politik pozitiv" (1851-54).
9. G. Hegel. 1821. *Parathënie. Parimet e filozofisë të së drejtës*. Tiranë.
10. A. G. Burgess & J. P. Burgess. 2011. *Truth* Princeton University Press (përmbledhje e përkufizimeve filozofike të të vërtetës) [a concise introduction to current philosophical debates about truth].
11. K. Popper. 1978. *Three worlds. Lecture on human values. Delivered at the University of Michigan*, pg. 26.

12. H. Gadame. 2008. *Histori e filozofisë. Përkth. A. Mukli. Tit. origj. Il cammino della filozofia.*
13. M. D. Hills. 2002. *Kluckhohn and Strodtbeck's Values Orientation Theory. University of Wikato, New Zealand, mhills@waikato.ac.nz.*
14. L. Pepin. 2009. *Teaching about Religions in European School Systems: Policy issues and trends. NEF Initiative on Religion and Democracy in Europe © Network of European Foundations.*
15. F. M. Muller. 1870. *The science of religion four lectures. New York.*
16. B. Russell. 1945. *A History of Western Philosophy. Simon Schuster and G. Allen&Unwin Ltd (UK).*

PJESA E DYTË

FORMIMI I MENDIMIT FETAR E FILOZOFIK
GJATË QYTETËRIMEVE TË LASHTA

II.1. Formimi i mendimit fetar e filozofik gjatë qytetërimeve të lashta

Kur flasim për qytetërimet, kemi parasysh se koncepti “*qytetërim*” përfshin jo vetëm idetë filozofike. Qytetërimi përfshin një gamë të gjerë vlerash të krijuara nga njerëzimi (njeriu).

Në ‘të integrohen feja, kultura materiale dhe shpirtërore, krijimtaria shpirtërore, intelektuale etj.,

Referenca jonë për të analizuar idetë filozofike në qytetërimet antike është lidhur me qytetërimet antike, në periudhën kohore, kur gjuha njerëzore është e shkruar me alfabet.

Në gjuhën dhe në dokumentet e shkruara (libra) gjenden edhe ide filozofike, krahas shumë ideve të tjera. Natyrisht, këto libra (dokumente) nuk janë libra të mirëfilltë filozofikë. Është kjo arsyeja që shpesh ndihemi në vështirësi për të dalluar pikëpamjet filozofike nga idetë fetare ose nga rregullat morale. Sidoqoftë, ne i përmbahemi pikëpamjes se “kultura” është në të vërtetë tema e përbashkët e të gjithë përkufizimeve të qytetërimit”.

Qytetërimet e para ndër më të njohurit deri sot janë hidrike, sepse lidhet me vendbanimet afër lumenjve Nil, Tigër, Eufrat, Hind e Gand, Huahhe.

Këto qytetërimet urbane datojnë 5000 vjet p.e.s. Qytetet e asaj kohe kanë sistem urbanizimi dhe drejtim administrativ të realizuar nga priftërinjtë.

Qytetërimet e lashta të paraardhësve tanë sot mund t’i njohim përmes zbulimit të fosileve, objekteve dhe qyteteve të shkatërruara. Njohja e ndonjërit prej tyre, si Atlantida, është bazuar në mitet dhe legjendat. Ne nuk mund të vlerësojmë dhe krahasojmë saktësisht rëndësinë e secilit, por mund të përmendim disa që janë më të vjetrat.

Mesopotamia (5000 p.l.k.-3000 p.l.k.) ishte qytetërimi i parë midis lumenjve Tigri dhe Eufrat (Azia Vogël dhe Gjiri Persik). Emri vjen nga greqishtja “*mesos*” (mes, midis) dhe “*potamos*” që do të thotë “*lumë*”. Pra, “*vend midis dy lumenjve*”.

Kulturat më të lashta në Mesopotami janë kulturat sumere, asire, akadiane dhe babilonase.

Qytetërimi i lashtë i Egjiptit (3100 p.l.k.-2686 p.l.k.) përgjatë brigjeve të lumit Nil. Piramidat madhështore janë dëshmi e kulturës egjiptiane. Ky qytetërim është paraardhësi i qytetërimit të sotëm egjiptian.

Qytetërimi i Trojës dhe Minoan janë më të lashtët në Europë, bashkë me qytetërimin roman.

Qytetërimi Minoan, i epokës së bronzit, në ishullin e Kretës të detit Egje, zgjati nga 3500 vjet p.l.k. deri 1100 e.s. Ai përfaqëson qytetërimin e parë në Europë. Emri “Minoan” rrjedh nga mbreti mitik Minos dhe labirinthi në Knossos⁽¹⁾.

Sipas Homerit, Kreta kishte 90 qytete. Katër pallate kryesore në ishull ishin Knossos, Phaistos, Malia dhe Kato Zakros. Gjurmët⁽²⁾ e këtij qytetërimi janë zbuluar në fillim të shek. XX.

Qytetërimi i lashtë roman (shek. VI p.l.k.) në brigjet e Mesdheut të sotëm. Themelimin e Romës së lashtë ne e njohim nga mitet dhe legjendat. Ndikimi i këtij qytetërimi përfshiu gjithë Europën e më tej. Ai është evident në ditën tona dhe tërheq miliona vizitorë.

Qytetërimi Maja (1200 p.l.k.-250 p.l.k.) rreth Amerikës Qendrore dhe Meksikës.

Qytetërimi Indus në luginën e lumit Ind (260 p.l.k.-1900 p.l.k.).

Qytetërimi i Kinës së lashtë fillon me dinastinë Shang (1600-1046 p.l.k.) në luginën e lumit të Verdhë dhe të lumit Jang Ce [Yangtze].

Të lashtët e lidhnin progresin me dyshen “*njeriu dhe bota*”. Ata argumentonin çdo të mirë dhe fatkeqësi me këtë lidhje duke përjashtuar një faktor të tretë dhe e vendosën racën njerëzore në planetin tokë që në fillim të qytetërimit. Ky është perceptimi i shkencëtarit të kohës sonë Stephen Haëking (1942-2018) në librin “Brief history of time” (2013).

Qytetërimet urbane lindore janë më të hershme se vit 10 000 p.e.s. Kjo kohë përkon me shkrirjen e akullnajave dhe ngritjen e nivelit të detyrave. Ndoshta kjo është edhe përmbytja që përmendet në Bibël. Duhet pranuar se përmbytje ka pasur edhe në herë të tjera dhe njerëzimi e ka nisur jetën nga e para.

Mendimi filozofik i Lindjes së Lashtë në vendet e Lindjes së Largët lidhet me fjalën “urtësi”. Kjo është kuptuar dhe vazhdon të kuptohet nga ne europianët si një dituri.

Njeri i urtë konsiderohet një njeri i ditur, ose një filozof.